REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**
**K.P.P. 349/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj | Anëtar |
| Lindita Skeja | Anëtar |
| Merita Zeqaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 28.08.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt**: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit "*Proccedurë e Hapur",* me nr. *REF-65892-07-18-2020,* me objekt *"F.V Pajisje mjekësore –CT Scanner"*, me fond limit 144.112.500 lekë (pa TVSH), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 17.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**Ankimues:** "Health &Light" sh.p.k.
Rruga "Themistokli Gërmenji", Pll.11,Shk. 4,Ap.4,Tiranë

"BNT Electronics" sh.p.k.
Bulevardi "Zhan D'ark", Ndërtesa 3, Hyrja 16, Kati II, Ap.1, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë

| | |
|---|---|
| **Baza Ligjore:** | Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik",* i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*". |

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

I

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 20.07.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit "Proccedurë e Hapur", me nr. REF-65892-07-18-2020, me objekt "F.V Pajisje mjekësore –CT Scanner", me fond limit 144.112.500 lekë

(pa TVSH), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 17.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2. Në datën 24.07.2020, operatori ekonomik ankimues "Health &Light" sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e kritereve të kualifikimit. Në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:
*[...]Me date 20.07.2020, eshte publikuar ne Sistemin Elektronik te Prokurimit Publik procedura e prokurimit me objekt: F.V Pajisje mjekesore - CT Scanner.*
*Na lejoni te shprehim sa me poshte vijon objeksionet tona ne lidhje me kete procedure prokurimi ne pergjithesi dhe me menyren se si jane hartuar specifikimet teknike ne vecanti. E gjejme kete procedure prokurimi te pergatitur teresisht per nje prodhim nga nje kompani e cila perfaqesohet ne territorin e Republikiës së Shqipërisë nga shoqeria "Montal" sh.p.k.. Me saktesisht, specifikimet e kerkuara teknike per CT Scanner 64 slice, flasin qarte per prodhimin REVOLUTION EVO GEN 2. ndersa per CT Scanner 16 slice, flasin qarte per prodhimin OPTIMA 540 16 slice Keto specifikime jane hartuar ne menyre te tilla qe i plotesojne vetem keto prodhime dhe askush tjeter.*
*Nga njera ane ato jane hartuar si nje fotokopje e keqe e prodhimeve te siperpermendura dhe nga ana tjeter veme re nje tendence mjaft te hapur qe kjo procedure prokurimi te fitohet nga shoqeria "MONTAL" sh.p.k.. Historikisht ne procedura te meparshme te hartuara dhe pergatitura nga ky ent prokurues nuk ka pasur asnjehere specifikime te cilat ishin perjashtuese per prodhues te tjere me emer si p.sh Siemens, Philips, Canon (Toshiba) etj. Duhet thene qe keta prodhues kane ne portofolin e tyre te prodhimeve mjaft specifikime superiore ndaj ketyre specifikimeve, por qe nuk jane vendosur sepse vendosin ne veshtiresi prodhimet e perfaqesuara nga shoqeria "Montal" sh.p.k.*
*Gjykimin e mesiperm e bazojme ne piketat e meposhtme :*
*A. CT Scanner 64 slice*
- *Gjeneratori i rrezeve X*

*Ka nje diskordance te madhe midis vlerave te kerkuara te fuqise se gjeneratorit te rrezeve X (pa/me permiresim nga softeare) te CT Scanner 64 slice me CT Scanner 16 slice. Me saktesisht ne CT Scanner 64 slice kerkohet : ≥ 48 kË/250 kË ndersa ne CT Scanner 16 slice kerkohet ≥ 50kË/85kË. Eshte pa kuptim te kerkosh vlera me te uleta te gjeneratorit per nje CT Scanner 64 slice ne raport me CT Scanner 16 slice. Nga ana tjeter vlerat e kerkuara ne specifikimet teknike te fteses per oferte, ishin fillimisht ≥ 55kË (per CT Scanner 64 slice), nderkohe qe me pas kjo vlere u tkurr dhe u vendos pa asnje logjike ≥ 48kË. Ky fenomen ndodhi ne rastin me te mire si nje konfuzion i shkaktuar nga mungesa e pervojes ne hartimin e specifikimeve teknike te ketij lloji pajisjesh dhe ne rastin me te keq si nje tendence per te coroditur dhe hutuar pjesemarresit ne kete gare duke vendosur fuqinë e gjeneratorit të një prodhimi nga një kompani e Lindjes së Largët thjesht e vetëm për të këmbëngulur që specifikimet teknike nuk janë të një prodhimi të përfaqësuar nga shoqëria "Montal" sh.p.k.por janë të hapura për shumë prodhues*
*Hapat e kerkuara te rregullimit te tensionit jane ≥ S 80 deri në ≥ 140 kV qe eshte tipike e prodhimit REVOLUTION EVO GEN 2. Pse nuk eshte kerkuar ≤ 70 deri ne ≥ 140 kV sepse kjo ben te mundur*

*edhe hartimin e mjaft protokolleve me doze te ulet ? Apo nuk e ploteson prodhimi i REVOLUTION EVO GEN 2 ? Pse duhet te vendoset vlera abuzive 250 kË me permiresim nga softëare ? Ku mund te matet ky permiresim ? Po prodhime te tjera qe kane permiresime te tipeve te tjera pse nuk jane pasqyruar? Ky parameter duhet hequr si mjaft teorik dhe aspak i matshem dhe duhet fshire.*

*Tubi i Rrezeve X*

*Ne parametrat e llambes se Rontgen-it specifikimet teknike vendosen perseri ne nivele vlerash ku prodhimi i REVOLUTION EVO GEN 2 ndihet komod. Me saktesisht : Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera nominale, pa permiresim nga softëeri), MHU kerkohet 7 MHU qe eshte perseri fotokopje e REVOLUTION EVO GEN 2 . Pse valle nuk kerkohet 8 MHU kur ka disa kompani qe e kane te tille, apo kjo e vendos REVOLUTION EVO GEN 2 ne veshtiresi ? Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja) eshte ≥ 1000 kHU ne nje kohe qe GE e ka 1070 ! ! ! ! Pse nuk vendoset vlera e largimit te nxehtesise ≥ 1600 kHU apo kjo e vendos REVOLUTION EVO GEN 2 ne veshtiresi ? Fokusi i vogel dhe i madh jane perseri zgjidhje teknike dhe vlerat jane vendosur qe REVOLUTION EVO GEN 2 te jete komode. Ato shume mire mund te ishin 0.5/1 dhe do kishin nje impakt mjaft te mire ne rezolucion hapesinor. Pse nuk jane vendosur te tilla ? Apo sepse nuk i ploteson REVOLUTION EVO GEN 2?*

*Gantry*

*Pjerresimi (real, jo digital), grade+/- 30.*

*Kerkojme te behet +/- 24 grade sepse prish konkurrencen*

*Numri total i elementeve te detektorit*

*Numri i kerkuar prej 54,000 tregon fare qarte qe ky specifikim eshte kopjuar nga katalogu i REVOLUTION EVO GEN 2 . Aty shprehet qe numri i elementeve eshte pak me i madh se sa 54,000 dhe menyra se si eshte vendosur tregon fare mire dhe fare qarte tendencen e hartuesve te specifikimeve teknike. Zgjidhja teknologjike e prodhuesve te tjere nuk ka nevoje per kaq shume elemente sepse kane teknologji te tille qe me me pak elemente marrin te njejtin rezultat, madje edhe me te mire ? Mos valle ka pasur ndonje ent spitalor ne SH.B.A apo BE ndonje pretendim per numrin e elementeve te detektorit per prodhues te tjere etj ?*

*Shkalla e absorbimit nga detektori dhe frekuenca e maksimale kampionimit*

*Keto parametra nuk kerkoheshin ne specifikimet teknike te fteses per oferte dhe jane vendosur tashme vetem e vetem per te perforcuar pozitat e prodhimit REVOLUTION EVO GEN 2. Ne vetvete keto jane parametra te cilat jane thellesisht te pamatshme dhe mjaft teorike sepse askush nuk mund t'i mase realisht dhe te jape nje gjykim nese jane vertet keto vlera apo jo. Keto duhen hequr si vlera teresisht te papershtatshme per t'u kerkuat ne nje gare normale dhe vlera qe ne thelb jane teorike.*

*Shtrati i pacientit*

*Kerkohet nje peshembajtje ≥ 225 kg nderkohe qe REVOLUTION EVO GEN 2 e ka 227 kg. Mos valle eshte nje rastesi ? Apo kaq e ka REVOLUTION EVO GEN 2 ? Eshte rastesi qe ne nje vend mesdhetar si Shqiperia qe nuk ka nje shkalle kaq te larte obeziteti të vendoset ky parametër ? Mos vallë kemi nivel obeziteti sa ne vendet e tjera te Evropes Veriore dhe Atlantikut te Veriut? Nuk kemi pare deri me sot nje shqiptar qe te jete me shume se 170 kg. Vlera qe mund te*

*vendoset mund te jete jo me e madhe se 200 kg. Edhe diapazoni i levizjes vertikale eshte mjaft abuziv dhe duhet te jete nga 55 cm aty ku eshte edhe lartesia mesatare e barreles.*
*Meqenëse jemi në kohë pandemie, pse nuk vendoset edhe kërkesa për të pasur "Kontroll të plotë në distance të shtratit të pacientit"? Per ti minimizuar kontaktin e operatorit me pacientin e sëmurë ? Apo sepse nuk e plotëson REVOLUTION EVO GEN2?*
*Performanca*
*Ketu shpaloset teresisht fotokopja e paster e vlerave te REVOLUTION EVO GEN 2 te cilat jane si me poshte vijon :*
*Boshti X-Y*
*- @50: 12.1 Ip/cm*
*-@10%: 16 Ip/cm*
*- @4%: 18.3 Ip/cm*
*- @0% > 18.3 Ip/cm*
*Mendojme se komentet jane te teperta.*
*CT Console - Kapaciteti Rindertues*
*Kerkohet rnatrice rindertimi 512x512. Pse nuk kerkohet nje matrice 1024x1024 ? Apo nuk plotesohet nga REVOLUTION EVO GEN 2 ? Nese dote mbetet 512x512 atehere te behet shpejtesia e ndertimit te imazheve 40 imazhe/sek*
*Kerkohet CPU 2 x Intel Xeon (ose ekuivalent), RAM ≥ 32GB, HDD ≥ lTB, 2 x LCD Color Monitors 19 inch, USB, Obit Ethernet. Keto jane karakteristika te cilat jane ne varesi te vete programeve aplikative si dhe te zgjidhjes teknologjike qe ofron vete prodhuesi. Gjithsesi RAM ≥ 32GB eshte mjaft e tepert dhe duhet te jete ≥16GB. Gjithashtu duke qene qe ne konfigurimin e kerkuar kerkohet edhe nje ëorkstation rishikimi atehere nuk ka kuptim qe te kerkohen 2 monitore ne CT Console.*
*Stacion pune (ëorkstation) i pavarur per perpunim te metejshern "post processing"*
*Pse nuk kërkohen MIP (Maximum Intensity projection), Surface MIP, MiniIP, VIP (volume intensity Projection)Volume rendering?*
*FDA*
*Nuk ka asnje lloj kuptimi vendosja e kerkeses per certifikim FDA sepse kjo certifikate nuk eshte e aplikueshme per vendet e Bashkimit Evropian dhe gjithashtu nuk ben pjese ne dokumentet qe kerkohen per regjistrimin e pajisjeve ne Territorin e Republikes se Shqiperise.*
*B. CT Scanner 16 slice*
- *Diapazon i gjeresise se prerjes, mm nga ≤ 0.7 deri ≥ 5 mm.*

*Eshte tipike e OPTIMA 540 16 slice. Per te pasur nje pjesemarrje sa me te gjere ju lutemi hapeni brezin ≤ 0.75 mm deri ≥ 5 mm.*
*Diapazon i gjeresise se prerjes, mm ≤ 0.625 mm.*
*Nuk ka kuptim kur ne një rresht me sipër kerkohet qe brezi te filloje nga 0.7 ketu kerkon qe prerja minimale te jete 0.625 mm. Eshte nje nonsens in madh. Ju lutem fshijeni si rresht dhe lini brezin ≤ 0.75 mm deri ≥ 5 mm.*
*Koha maksimale e nje rrotullimi 360°, sekonda.*

*Perseri nje nonsens i madh qe ka prape lidhje me mënyrën se si janë fotokopjuar specifikimet nga OPTIMA 54016 slice. Nuk ka protokoll sot qe mund te kerkoje kohe te madhe rrotullimi me shurne se 4 sekonda. Ju lutem vendoseni ≥ 1,5 sekonda sepse nuk percakton asnje lloj arritje qofte ne cilesi imazhi apo ne shpejtesine e ekzaminimit. Eshte thjesht artifice qe sherben per OPTIMA 540 16 slice.*
*Numri i opsioneve per zgjedhjen e kohes per nje rrotullim 360°, 8.*
*Sa hap katalogun e OPTIMA 540 16 slice arrin ta shohesh qe jane 8 zgjedhje kohe. Te behet min ≥ 6. Thjesht pengon konkurrencen.*
*Monitor i integruar ne gantry per paraqitjen e te dhenave te pacientit dhe kontroll te pozicionimit me ane te prekjes ne monitor.*
*Te hiqet si specifikim sepse nuk ka asnje lloj kuptimi dhe eshte mjaft specifik dhe i tepruar. Nuk perben asnje lloj perftirni dhe eshte nje specifikim qe e permbush vetern OPTIMA 540 16 slice.*
*Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera nominale, pa perrniresirn nga softueri), 6 MHU...*
*Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja) 750 kHU. Eshte mjaft qesharak fakti qe per CT Scanner 64 slice vendosen parametra te ulet te llambes kurse ketu kerkohen te larte per nje CT 16 slice... ??? Mos valle eshte rastesi dhe gabim njerezor apo eshte tendence e hapur per te perzgjedhur OPTIMA 540 16 slice??? Per te hapur specifikimet kerkojrne*
*qe te vendoset ≥ 5 MHU dhe 70 kHU*
*Fuqia, kË (vlera ekuivalente, me permiresim nga softueri)*
*Kerkojrne qe kjo pike ashtu si te 64 slice te hiqet sepse eshte aspak relevante dhe mjaft abuzive.*
*Diapazoni ne dispozicion, kV nga ≤ 80 deri ne ≥140 kV Ne nje CT 16 slice mund te jete fare mire edhe ≤ 90 deri ne ≥ 135 kV nuk ka pse te shkohet nga pas specifikimeve te OPTIMA 54016 slice ne secilin rresht.*
*Koha minimale e imazheve te rindertuar me matrice 512X512. Pse nuk bëhet 1024x 1024 apo nuk e ka OPTIMA 540 16 slice. Pse nuk behet 20 imazhe ne sekonde?*
*Njesia e perpunimit qendror CPU 2 x Intel Xeon (ose me mire), RAM≥16GB, HDD ≥ lTB, 2 x LCD Color Monitors 19inch, Karte grafike profesionale ≥ 2GB, USB, Ethernet ... Keto jane zgjidhje Te hiqen kerkesat specifikime mbi hardëare-in e ëorkstation, ato jane zgjidhje teknologjike te cilat nuk prekin performancen e kerkuar, jane vetern numra qe cenojne konkurrencen, Pse duhet te kerkohen 2 monitore nderkohe qe eshte kerkuar me poshte stacion i punes i pajisur me 2 monitore. kerkesa per dy monitore e panevojshme dhe cenon konkurrencen.*
*Sistemi te jete i afte te marre imazhe ne modalitetin aksial dhe spiral duke perdorur dy energji te ndryshme x-ray per shtim te informacionit klinik*
*Te hiqet si specifikim, specifikim ekskluzivisht I OPTIMA 540 16 slice . Te hiqet per tu gjithe-perfshirje. Me kete kerkese cenohet rende konkurrenca*
*Stacion pune (ëorkstation) i pavarur per perpunlrn te metejshem "post processing"*
*Pse nuk kërkohen MIP (Maximum Intensity projection), Surface MIP, MiniIP, VIP (volume intensity Projection)Volume rendering?*
*FDA*
*Nuk ka asnje lloj kuptimi vendosja e kerkeses per certifikim FDA sepse kjo certifikate nuk eshte e aplikueshme per vendet e Bashkimit Evropian dhe gjithashtu nuk ben pjese ne dokumentet qe kerkohen per regjistrimin e pajisjeve ne Territorin e Republikes se Shqiperise.*

*Kerkojrne ndryshimin e rnenjehershern te specifikimeve teknike si fotokopje te prodhimeve te siperpermednura dhe rnundesimin qe prodhues te tjere mne erner te mund te marrin pjese ne kete procedure prokurimi.*
*Besojme se kerkesa jone eshte e drejte, e bazuar ne ligj dhe dote merret parasysh, ne menyre qe te kete konkurence ne kete procedure prokurimi.[...]*
II.2.1. Autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e pranuar pjesërisht atë, me argumentimin si më poshtë vijon:
*[...]Lidhur me kerkesen:*
*Ne lidhje me specifikimin:*
*Diapazoni ne dispozicion, kV nga ≤ 80 deri ne ≥140 kV,*
*OE kerkon qe ky specifikim te behet nga ≤ 70 deri ne ≥ 140 kV*

*AK pasi beri verifikimet perkatese konstatoi se pergjithesisht ky specifikim plotesohet nga pajisjet e ngjashme te prodhuesve te ndryshem por gjithashtu konstaton se prodhues te ndryshem per kete kategori kane devijime te vogla ne lidhje me diapazonet e tensioni apo rrymes. Nisur nga moscenimi i cilesise nga keto devijime te vogla ne diapazonin e rrymes, AK vendos qe pretendimi i OE qendron pjeserisht dhe ben modifikimin si me poshte:*

*Ishte*
*Diapazoni ne dispozicion, kV nga ≤ 80 deri ne ≥ 140 kV,*
*Behet*
*Diapazoni ne dispozicion, kV nga ≤ 80 deri ne ≥135 kV*

*Ne lidhje me ankesen e OE per specifikimin: Pjerresimi (real, jo digital), grade ± 30° ku kerkoni qe kjo pjerresi te jete me e vogel, AK pasi beri verifikimet perkatese konstatoi se prodhuesit kane kategori te ndryshme te pajisjeve dhe nga verifikimet e bera rezultoi se ky specifikim plotesohet nga kategorite e ngjashme te pajisjes objekt i kesaj procedure prokurimi te prodhuara nga prodhues te ndryshem. Ankesa e OE nuk qendron.*

*Referuar pikes tjeter te ankeses, OE kerkon qe te hiqen specifikimet:*
*Shkalla e absorbimit nga detektorit ≥ 98% dhe*

*I pajisur me sistem te avancuar marrje te dhenash per permiresim maksimal te perfomances se imazhit, reduktim maksimal zhurmash dhe frekuence maksimale te kampionimitjo me pak se: ≥ 2400Hz*

*AK beri verifikimet perkatese me qellim qe te vleresoje pretendimin e OE. Nga ky verifikim konstatoi se ky specifikim shpesh nuk reflektohet ne kataloge dhe mund te jete i veshtire verifikimi i tyre. AK konstaton se pretendimi i OE qendron dhe per kete arsye vendos te mane parasysh ankese per ta hequr kete specifikim.*
*Ishte*

*Shkalla e absorbimit nga detektorit ≥ 98% dhe*
*I pajisur me sistem te avancuar marrje te dhenash per permiresim maksimal te perfomances se imazhit, reduktim maksimal zhurmash dhe frekuence maksimale te kampionimit Jo me pak se: ≥ 2400Hz*

*Behet*
*Hiqet specifikimi: Shkalla e absorbimit nga detektorit ≥ 98% dhe i pajisur me sistem te avancuar marrje te dhenash per permiresim maksimal te perfomances se imazhit, reduktim maksimal zhurmash dhe frekuence maksimale te kampionimit Jo me pak se ≥ 2400Hz.*
*Ne lidhje me specifikimet e shtratit, Kapaciteti i peshes se shtratit, kg ≥ 225 kg, Diapazoni i Levizjes vertikale, cmnga ≤ 50 deri ne ≥ 80 cm, OE kerkon qe kapaciteti mbajtes te zvogelohet ne vleren 200 kg dhe po keshtu levizja vertikale e cila kerkohet te behet nga ≤ 55 deri ne ≥ 80 cm*
*Me qellim mirepercaktimin e objektit te prokurimit eshte e nevojshme vendosja e specifikimeve qe mirepercaktojne te dhenat teknike te pajisjes ne menyre sa me te plote. Per kete arsye AK ka vendosur edhe kerkesen per gjatesine e shtratit. Ne lidhje peshen e shtratit, AK beri verifikimet perkatese dhe konstatoi se specifikimi i kerkuar plotesohet nga shume prodhues per kategorine e kerkuar te kesaj pajisjeje. Ne lidhje me peshen e shtratit AK gjykon se per cdo rast cdo strukture spitalore duhet te kete ne dispozicion pajisje te kesaj kategorie te afte per ti ofruar sherbim edhe pacienteve me obezitet te larte aq me teper kur prodhohet nga te gjithe prodhuesit dhe i vendos ata ne te njejtin nivel teknologjie.*
*Per sa me siper AK konstaton se ankesa e OE qendron pjeserisht dhe vendos te beje ndryshimin si me poshte:*
*Ishte*
*Kapaciteti i peshes se shtratit, kg ≥ 225 kg*
*Behet*
*Kapaciteti i peshes se shtratit, kg ≥ 220 kg*
*Ishte*
*Diapazoni i Levizjes vertikale, cmnga ≤ 50 deri ne ≥ 80 cm*
*Behet*
*Diapazoni i Levizjes vertikale, cmnga ≤ 55 deri ne ≥ 80 cm*

*Ne lidhje me specifikimet: Njesia e perpunimit qendror CPU 2 x Intel Xeon (ose me mire), RAM ≥16GB, HDD≥ 1TB, 2 x LCD Color Monitors 19inch, Karte grafike profesionale ≥ 2GB, USB, Ethernet , OE pretendon qe kjo kerkese te hiqet ose ti lihet hapesire cdo operatori ti vendose vete.*
*Ne lidhje me kete pretendim, AK duhet te mirepercaktoje te gjitha specifikimet me qellim vleresimin same te drejte te operatoreve. AK beri verifikimet perkatese dhe vendosi qe te beje modifikimin si me poshte:*

*Ishte*
*Njesia e perpunimit qendror CPU 2 x Intel Xeon (ose me mire), RAM ≥ 16GB, HDD≥1 TB, 2 x LCD Color Monitors 19inch, Karte grafike profesionale ≥2GB, USB, Ethernet*

*Behet*
*Njesia e perpunimit qendror CPU 2 x Intel Xeon (ose me mire), RAM ≥16GB, HDD ≥ 1 TB, 1 ose 2 x LCD Color Monitors 19inch, Karte grafike profesionale ≥ 2GB, USB, Ethernet*

*Ne lidhje me kerkesen qe pajisja te jete FDA, OE kerkon qe kjo kerkese te hiqet.*
*OE beri verifikimet perkatese dhe referuar Ligjit 89/2014 "Per pajisjet mjekesore" te ndryshuar, AK konstaton se pretendimi i OE qendron dhe pranon kerkesen e OE per heqjen e kriterit per paraqitjen e miratimit FDA. AK vendos te beje ndryshimin e meposhtem*

*1. Ishte*
*Certifikime te Skanerit: FDA Certifikime te Skanerit CE*

*· Behet*
*Certifikime te Skanerit: CE ose FDA*

*CT 16*

*Ne lidhje me specifikimin Diapazon i gjeresise se prerjes, mm nga ≤ 0.7 deri ≥ 5 mm, OE kerkon qe ky specifikim te ndryshohet dhe te behet ≤ 0.75 deri ≥ 5 mm*
*Ne lidhje me kete pretendim, AK beri verifikimet. Nga ky verifikim konstatoi se ky specifikim ofrohet gjeresisht nga teknologjite e ndryshme te se njejtes kaategori dhe per kete arsye, me pretendimi i OE nuk qendron.*
*Ne lidhje me kete specifikim dhe specifikimin Minimumi i trashesise se prerjes, mm ≤ 0.625 mm AK kontrolloi te dhenat teknike te prodhuesve te ndryshem dhe konstatoi nje mosperputhje ne kerkesat e ketyre dy specifikimeve. Per te saktesuar kerkesat teknike AK ben modifikimin e meposhtem:*
*Ishte:*
*Diapazon i gjeresise se prerjes, mm nga ≤ 0.7 deri ≥ 5 mm,*
*Minimumi i trashesise se prerjes, mm ≤ 0.625 mm.*
*Behet*
*Diapazon i gjeresise/trashesise se prerjes, mm nga ≤ 0.65 deri ≥ 5 mm*
*Specifikimi Minimumi i trashesise se prerjes, mm ≤ 0. 625 mm Hiqet*

*Ne lidhje me specifikimin Koha maksimale e nje rrotullimi 360°, sekonda ≥ 4 sec, OE kerkon qe ajo te ndryshohet dhe te behet 1.5 sec.*
*Ne lidhje me kete pretendim, AK beri verifikimet. Me qellim rritjen e metejshme te pjesemanjes dhe garantimin e parimit te barazise, konkurences dhe mosdiskriminimit te percaktuar ne ligjin e prokurimeve, AK kontrolloi te dhenat teknike te prodhuesve te ndryshem dhe vendosi te beje modifikimin si me poshte:*

*Ishte*
*Koha maksimale e nje rrotullimi 360°, sekonda ≥ 4 sec*
*Behet*
*Koha maksimale e nje rrotullimi 360°, sekonda ≥ 2 sec*

*Ne lidhje me specifikimin Monitor i integruar ne gantry per paraqitjen e te dhenave te pacientit dhe kontroll te pozicionimit me ane te prekjes ne monitor kerkohet Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar, OE pretendon se i referohet nje teknogjie te caktuar por nuk ka nje kerkese specifike se cfare kerkon te ndryshoje.*
*AK ne lidhje me kete specifikim dhe nga menyra e formulimit te saj kerkon qe te vleresohet performance e cila mund te arrihet me zgjidhje te ndryshme teknologjike. Per kete arsye me qellim garantimin e konkurences, AK vendos te beje ndryshimin si me poshte:*
*Ishte*
*Monitor i integruar ne gantry per paraqitjen e te dhenave te pacientit dhe kontroll te pozicionimit me ane te prekjes ne monitor kerkohet Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar.*

*Behet*
*Monitor i integruar ne gantry per paraqitjen e te dhenave te pacientit dhe kontroll te pozicionimit me prekje ose butona kerkohet Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar.*
*Ne lidhje me specifikimin Numri i opsioneve per zgjedhjen e kohes per nje rrotullim 360 grade ≥ 8, OE kerkon ndryshimin e tij me 6 opsione.*
*Ne lidhje me kete pretendim, AK beri verifikimet perkatese. Me qellim rritjen e metejshme te pjesemanjes ne kete konkurim dhe garantimin e parimit te barazise, konkurences dhe mosdiskriminimit te percaktuar ne ligjin e prokurimeve AK vendosi te beje modifikimin si me poshte:*
*Ishte*
*Numri i opsioneve per zgjedhjen e kohes per nje rrotullim 360° ≥8*

*Behet*
*Numri i opsioneve per zgjedhjen e kohes per nje rrotullim 360° ≥ 6*

*Ne lidhje me specifikimin Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera nominale, pa permiresim nga softëeri), MHU ≥6 MHU, Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja) ≥ 840 kHU/min OE kerkon ndryshimet respektive ne vlerat 5 dhe 750KhU.*

*Ne lidhje me kete pretendim, AK beri verifikimet perkatese. Nga ky verifikim konstatoi se pretendimi i OE qendron per kerkesen e pare dhe qendron pjeserisht per te dyten. AK kontrolloi te dhenat teknike te prodhuesve te ndryshem dhe vendosi te beje modifikimet si me poshte:*
*Ishte*
*Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera nominale, pa permiresim nga softueri), MHU: ≥ 6*
*MHU, Behet*

*Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera nominale, pa permiresim nga softueri), MHU: ≥ 5 MHU,*
*Ishte*
*Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja) ≥ 840 kHU/min*
*Behet*
*Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja) ≥ 800 kHU/min*
*Ne lidhje me specifikimin e gjeneratorit Fuqia, kË (vlera ekuivalente, me permiresim nga softëeri) ≥ 85 kË kerkohet heqja e rritjes me softëare si dhe permiresimi me softëare i rrymes.*
*Ne lidhje me kete pretendim, AK beri verifikimet perkatese. Nga ky verifikim konstatoi se pretendimi i OE qendron per kerkesen e pare. AK kontrolloi te dhenat teknike te prodhuesve te ndryshem dhe konstatoi qe pretendimi i OE qendron pjeserisht dhe vendosi te beje modifikimin si me poshte:*

*Ishte*
*Fuqia, kË (vlera ekuivalente, me permiresim nga softueri) ≥ 85 kË*
*Behet*
*Fuqia, kË (vlera ekuivalente, me permiresim nga softueri) ≥ 80 kË*

*Ne lidhje me specifikimin Diapazoni ne dispozicion, kV nga ≤ 80 deri ne ≥ 140 kV, OE kerkon heqjen ose modifikimin e tij ne nje nga ≤ 90 deri ne ≥ 135 kV.*

*AK pasi beri verifikimet perkatese konstatoi se ky specifikim nuk duhet te hiqet dhe se pergjithesisht plotesohet nga pajisjet e ngjashme te prodhuesve te ndryshem por gjithashtu konstaton se prodhues te ndryshem per kete kategori kane devijime te vogla ne lidhje me diapazonet e tensioni apo rrymes. Nisur nga moscenimi i cilesise nga keto devijime te vogla ne diapazonin e rrymes, AK vendos qe pretendimi i OE qendron dhe ben modifikimin si me poshte:*

*lshte*
*Diapazoni ne dispozicion, kV nga ≤ 80 deri ne ≥ 140 kV,*
*Behet*
*Diapazoni ne dispozicion, kV nga≤ 90 deri ne ≥135 kV.*

*Ne lidhje me specifikimet: Njesia e perpunimit qendror CPU 2 x Intel Xeon (ose me mire), RAM ≥16GB, HDD≥1TB, 2 x LCD Color Monitors 19inch, Karte grafike profesionale ≥ 2GB, USB, Ethernet , OE pretendon qe kjo kerkese te hiqet ose ti lihet hapesire cdo operatori ti vendose vete.*

*Ne lidhje me kete pretendim, AK duhet te mirepercaktoje te gjitha specifikimet me qellim vleresimin sa me te drejte te operatoreve. AK beri verifikimet perkatese dhe vendosi qe te beje modifikimin si me poshte:*

*Ishte*
*Njesia e perpunimit qendror CPU 2 x Intel Xeon (ose me mire), RAM ≥16GB, HDD ≥ lTB, 2 x LCD Color Monitors 19inch, Karte grafike profesionale ≥2GB, USB, Ethernet*
*Behet*
*Njesia e perpunimit qendror CPU 2 x Intel Xeon (ose me mire), RAM ≥16GB, HDD ≥l TB, 1 ose 2 x LCD Color Monitors 19inch, Karte grafike profesionale ≥ 2GB, USB, Ethernet.*

*Ne lidhje me specifikimet: Sistemi te jete i afte te marre imazhe ne modalitetin aksial dhe spiral duke perdorur dy energji te ndryshme x-ray per shtim te informacionit klinik, OE kerkon qe ky specifikim te hiqet.*

*Ne lidhje me kete pretendim, AK beri verifikimet. Me qellim rritjen e metejshme te pjesemarrjes dhe garantimin e parimit te barazise, konkurences dhe mosdiskriminimit te percaktuar ne ligjin e prokurimeve, meqenese verifikimi i ketij specifikimi mund te jete i veshtire per tu konfirmuarvendos heqjen e ketij specifikimi.*

*Ne lidhje me kerkesen qe pajisja te jete FDA, OE kerkon qe kjo kerkese te hiqet.*
*OE beri verifikimet perkatese dhe referuar Ligjit 89/2014 "Per pajisjet mjekesore" te ndryshuar, AK konstaton se pretendimi i OE qendron dhe pranon kerkesen e OE per heqjen e kriterit per paraqitjen e miratimit FDA. AK vendos te beje ndryshimin e meposhtem*

*2. Ishte*
*Certifikime te Skanerit: FDA Certifikime te Skanerit CE*

*Behet*
*Certifikime te Skanerit: CE ose FDA*

*Ky sqarim i komunikohet rnenjehere OE "HealthLight"Sh.p.k (edhe ne adresen e email-it). Komisioni ka rekomanduar modifikimin e DST te kesaj procedure prokurimi ne perputhje me sqarimet e dhena ne kete ankese. Komisioni rekomandon Njesine e Prokurimit qe modifikimet dhe sqarimet te behen te ditura per te gjithe operatoret e interesuar, nepermjet SPE.[...]*

II.2.2. Në datën 05.08.2020 operatori ekonomik “Health &Light” sh.p.k., ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të tenderit, me pretendimin si më poshtë vijon:
*[...] Shoqeria Health &Light shpk eshte e interesuar qe te marre pjese ne proceduren e prokurimit me objekt: "F.V Pajisje mjekesore=C'T Scanner".*
*Pasi shqyrtuam me vemendje specifikimet teknike te kerkuara ne kete procedure prokurimi, paraqitem nepermjet ankeses pretendimet tona me date 24.07.2020 prane Autoritetit Kontraktor, te cilen po e bashkengjisim.*

*E gjejme kete procedure prokurimi te pergatitur teresisht per nje prodhim nga nje kompani e cila perfaqesohet ne territorin e Republikes se Shqiperise nga shoqeria MONTAL Sh.p.k. Me saktesisht, specifikimet e kerkuara teknike per CT Scanner 64 slice, flasin qarte per prodhimin REVOLUTION EVO GEN*
*2_. ndersa per CT Scanner 16 slice, flasin qarte per prodhimin OPTIMA 540 16 slice Keto specifikime [ane hartuar ne rnenvre te tilla qe i plotesojne vetern keto prodhime dhe askush tjeter.*
*Nga njera ane ato jane hartuar si nje fotokopje e keqe e prodhimeve te siperperrnendura dhe nga ana tjeter verne re nje tendence mjaft te hapur qe kjo procedure prokurimi te fitohet nga shoqeria "Montal" sh.p.k.. Historikisht ne procedura te meparshme te hartuara dhe pergatitura nga ky ent prokurues nuk ka pasur asnjehere specifikime te cilat ishin perjashtuese per prodhues te tjere me erner si p.sh Siemens, Philips, Canon (Toshiba) etj. Duhet thene qe keta prodhues kane ne portofolin e tyre te prodhimeve mjaft specifikime superiore ndaj ketvre specifikimeve par qe nuk jane vendosur sepse vendosin ne veshtiresi prodhimet e perfaqesuara nga shoqeria "Montal" sh.p.k.*
*Gjykimin e mësipërm e bazojmë në piketat e mëposhtme:*

*Gjeneratori i rrezeve X*
*1.*
*Autoritetit Kontraktor iu shpjegua ne ankesen tone qe : Ka nje diskordance te madhe midis vlerave te kerkuara te fuqise se gjeneratorit te rrezeve X (pa/me perrniresim nga softëare) te CT Scanner 64 slice me CT Scanner 16 slice. Me saktesisht ne CT Scanner 64 slice nga ana e AK kerkohet ≥ 48 kë/250 kË ndersa ne CT Scanner 16 slice kerkohet ≥ 50kË/85kË. Eshte pa kuptim qe ata te kerkojne vlera me te uleta te gjeneratorit per nje CT Scanner 64 slice ne raport me CT Scanner 16 slice. Nga ana tjeter vlerat e kerkuara ne specifikimet teknike te fteses per oferte qe paraqiti AK, ishin fillimisht ≥ 55kË (per CT Scanner 64 slice), nderkohe qe me pas kjo vlere u tkurr dhe u vendos pa asnje logjike ≥ 48kË. Sipas arsyetimit tone, ky fenomen ndodhi ne rastin me te mire si nje konfuzion i shkaktuar nga mungesa e pervojes ne hartimin e specifikimeve teknike te ketij lloji pajisjesh dhe ne rastin me te keq si nje tendence per te coroditur dhe hutuar pjesemarresit ne kete gare duke vendosur fuqine e qieneratorit te nie prodhimi nqa nie kompani e Lindjes se Larget thjesht e vetem per te "kembengulur" që specifikimet teknike nuk jane te nje prodhimi te perfaqesuar nqa shoqeria "Montal" sh.p.k., por jane te hapura per shume prodhues.*
*Ne pergjigjen e tij, Autoriteti Kontraktor, per fuqine e gjeneratorit te rrezeve X per CT Scanner 64 slice nuk shprehet fare ne nje kohe qe vlerat jane mjaft te cuditshme dhe jo ne raport normal teknik me kerkesat e gjeneratorit te CT Scanner 16 slice.*

*2. Ne specifikimet e hartuara nga AK, vihen re: Hapat e kerkuara te rregullimit te tensionit jane ≤ 80 deri ne ≥140 kV gje qe eshte tipike e prodhimit REVOLUTION EVO GEN 2. Pse nuk eshte kerkuar ≤ 70 deri ne ≥140 kV sepse kjo ben te mundur edhe hartimin e mjaft protokolleve me doze te ulet ?*

*Apo nuk e ploteson prodhimi i REVOLUTION EVO GEN 2 ? Ne pergjigjen e tij, Autoriteti Kontraktor ne vend qe te ule pjesen e poshtme te brezit (pra te beje 70 kV ne vend te 80 kV ne menvre qe te kete protokolle me sa me pak doze) ..... cfare ben ne fakt ? Thjesht ul pjesen e siperrne te brezit nga 140 kV ne 135 kV !! !! !! E kuptueshme nga kushdo per te mos prishur pune produktit te parazgjedhur.*
*3. I kerkuam AK arsyen pse duhet te vendosen vlera abuzive 250 kë me perrniresimin nga softëare ? Ku mund te matet ky permisim ? Po prodhime te tjera qe kane përmirsime te tipeve te tjera pse nuk jane pasqyruar? Ky parameter duhet hequr si mjaft teorik dhe aspak i rnatshern dhe duh et fshire. Ne pergjigjen e tij AK nuk shprehet fare per kete vlere*

*Tubi i Rrezeve X*
*Ne parametrat e llambës se Rontgen-it specifikimet teknike te AK vendosin perseri ne nivele vlerash ku prodhimi i REVOLUTION EVO GEN 2 te ndihet komod. Me saktesisht: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera nominale, pa permiresim nga softëeri), MHU kerkohet 7 MHU qe eshte perseri fotokopje e REVOLUTION EVO GEN 2. Pse val le nuk kerkohet 8 MHU kur ka disa kompani qe e kane te tille, apo kjo e vendos REVOLUTION EVO GEN 2 ne veshtiresi? Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja) eshte ≥1000 kHU ne nje kohe qe GE e ka 1070 !! !! Pse nuk vendoset vlera e largimit te nxehtesise ≥ 1600 kHU apo kjo e vendos REVOLUTION EVO GEN ne veshtiresi ? Fokusi i vogel dhe i madh jane perseri zgjidhje teknike dhe vlerat jane vendosur qe REVOLUTION EVO GEN 2 te jete komode. Ato shurne mire mund te ishin 0.5/1 dhe do kishin nje impakt mjaft te mire ne rezo/ucion hopesinor. Pse nuk jane vendosur te tilla ? Apo sepse nuk i ploteson REVOLUTION EVO GEN 2 ?*
*Edhe ketu AK nuk jep asnje lloj shpjegimi apo sqarimi ne lidhje me ankesën tonë.*
*Gantry*
*Pjerresimi (real, jo digital), grade+/- 30.*
*Kerkojrne te behet +/- 24 grade sepse prish konkurrencen*
*Ne ditet e sotme skanerat po pjerresohen gjithmone e me pak per shkak te pranise se rikonstruksioneve te cilat e kryejne me shpejt ekzamionimin dhe operatori nuk humebt kohe te cmuar duke bere levizje gjeometrike te CT Scanner-it. Ne kete optike synimi eshte thjesht qe te perjashtohen me një menyre ose nje tjeter kompani te cilat mjaft prestigjioze vetern nepermjet luftes se numrave nga kompania "Montal" sh.p.k.*
*Numri total i elementeve te detektorit*
*Numri i kerkuar prej 54,000 tregon fare qarte qe ky specifikim eshte kopjuar nga katalogu i REVOLUTION EVO GEN 2. Aty shprehet qe numri i elementeve eshte pak me i madh se sa 54,000 dhe mënyra se si eshte vendosur tregon fare mire dhe fare qarte tendencen e hartuesve te specifikimeve teknike. Zgjidhja teknologjike e prodhuesve te tjere nuk ka nevoje per kaq shurne elemente sepse kane teknologji te title qe me me pak elemente marrin te njejtin rezultat, madje edhe mete mire? Mos valle ka pasur ndonje ent spitalor ne SH.B.A apo BE ndonje pretendim per numrin e elementeve te detektorit per prod hues te tjere etj ?*
*Shtrati i pacientit*

*Kerkohet nje peshernbajtje ≥ 225 kg nderkohe qe REVOLUTION EVO GEN 2 e ka 227 kg. Mos valle eshte nje rastesi ? Apo kaq e ka REVOLUTION EVO GEN 2? Eshte rastesi qe ne nje vend mesdhetar si Shqiperia qe nuk ka nje shkalle kaq te larte obeziteti te vendoset ky parameter? Mos vallë kemi nivel obeziteti sa ne vendet e tjera te Evropes Veriore dhe Atlantikut te Veriut? Nuk kemi pare deri me sot nje shqiptar qe te jete me shurne se 170 kg. Viera qe mund te vendoset mund te jete jo me e mad he se 200 kg.*

*Autoriteti kontraktor gjykoi ne pergjigjen e tij qe kapaciteti peshembajtes i shtratit mund te bëhet*

*220 kg ne nje kohe qe paciente te tille nuk ka per te patur ndonjëhere dhe nuk shqetesohet aspak qe te vendosë nje kusht mjaft te thjeshte dhe mjaft aktual, sidomos ne kohen qe jetojmë. Pra, Kontroll te plote ne distance te shtratit te pacientit per te minimizuar kontaktin e operatorit me pacientin e semure. Pse nuk vendoset? Apo sepse nuke ploteson REVOLUTION EVO GEN 2 ?*

*Performanca*

*Ketu shpaloset teresisht fotokopja e paster e vlerave te REVOLUTION EVO GEN 2 te cilat jane si me poshte vijon :*

*Boshti X-Y*

*- @SO: 12.1 Ip/cm*

*-@10%: 16 Ip/cm*

*- @4%: 18.3 Ip/cm*

*- @0% > 18.3 Ip/cm*

*Mendojme se komentet jane te teperta. Madje AK as ka marrë mundimin qe te marrë ne konsiderate per ta shqyrtuar kerkesen tonë!!!*

*CT Console - Kapaciteti Rindertues*

*Kerkohet matricë rindërtimi 512x512. Pse nuk kerkohet një matricë 1024x1024? Apo nuk plotesohet nga REVOLUTION EVO GEN 2? Nese do te mbetet 512x512 atehere te behet shpejtesia e ndertimit te imazheve 40 imazhe/sek*

*Stacion pune (ëorkstation) i pavarur për përpunim të mëtejshëm "post processing". Pse nuk kërkohen MIP (Maximum Intensity Projection), surface MIP,MiniIP, vip ( volume intensityProjection) Volume rendering?*

*B. CT Scanner 16 slice*

*Diapazon i gjeresise se prerjes, mm nga ≤ 0.7 deri ≥ 5 mm.*

*Eshte tipike e OPTIMA 540 16 slice. Per te pasur nje pjesernarrje sa me te gjere ju lutemi hapeni brezin ≤ 0.75 mm deri ≥ 5 mm.*

*Autoriteti kontraktor madje shkon edhe e thellon edhe me tej rnungesen e paanshrnerise duke e ulur edhe me tej ne 0.65 mm.*

*Monitor i integruar ne gantry per paraqitjen e te dhenave te pacientit dhe kontroll te pozicionimit me ane te prekjes ne monitor.*

*U kerkua te hiqet si specifikim sepse nuk ka asnje lloj kuptimi dhe eshte mjaft specifik dhe i tepruar. Nuk perben asnje lloj perftimi dhe eshte nje specifikim qe e perrnbush vetem OPTIMA 540 16 slice.*

*AK gjykoi se ishte e drejte dhe e la te tillë, me te vetmin ndryshim qe shtoi edhe me butona, pervec prekjes. Nuk arrijme ta kuptojrne se cfare relevance klinike ka shfaqja e nje emri ne nje ekran te gantry, kur ne ate dhorne gjate skanimit ndodhet vetem pacienti dhe askush tjeter, Pse valle kjo gje nuk kerkohet te CT Scanneri me i avancuar (prate 64 slice) por kerkohet ketu ? Mos valle eshte thjesht rastesi ?*

*Ne kete drite iu shpjegua Autoritetit kontraktor edhe per Kapacitetin ngrohes te Anodes (vlera nominale, pa permiresim nga softëeri), 6 MHU ... Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja) 750 kHU. Eshte mjaft qesharak fakti qe per CT Scanner 64 slice vendosen parametra te ulet te llambës kurse ketu kerkohen te larte per nje CT 16 slice ... ??? Mos valle eshte rastesi dhe gabim njerezor apo eshte tendence e hapur per te perzgjedhur OPTIMA 540 16 slice??? Per te hapur specifikimet kerkuarn qe te vendoset ≥ 5 MHU dhe 700 kHU........Autoriteti ndersa merr parasysh Kapacitetin dhe e ndryshon nga 6 ne 5 MHU ..... nuk e zbret edhe Largimin e nxehtesise se Anodes po ne te njejtin raport por e zbret mjaft pak nga 840 e ben 800 kHU.*

*Fuqia, kË (vlera ekuivalente, me permisim nga softëare)*

*Kerkojme qe kjo pike ashtu si te 64 slice te hiqet sepse eshte aspak relevante dhe mjaft abuzive. Nese ne rastin e CT Scanner me 64 slice AK nuk jep asnje lloj sqarimi apo shpjegimi, ketu thjesht kufizohet duke bere nje ulje simbolike, por gjithsesi duke ruajtur tabanin pra përmirsimin neperrnjet softëare ..*

*Koha minimale e imazheve te rindertuar me matrice 512X512 . Pse nuk behet 1024x 1024 apo nuk e ka OPTIMA 54016 slice. Pse nuk behet 20 imazhe ne sekonde?*

*Stacion pune (ëorkstation) i pavarur per perpunirn te rnetejshem "post processing"*

*Pse nuk kerkohen MIP (Maximum Intensity projection), Surface MIP, MinilP, VIP (volume intensity*

*Projection)Volume rendering?*

*Ne kuadrin jo teknik AK nuk jep asnje lloj sqarimi ne DST ne lidhje me pagesat. Si do te veprohet nese buxheti do te skadoje per shkak te vonesave qe mund te ndodhin nga spitalet me pergatitjen e ambienteve ku do te instalohen pajisjet e sipercituara?*

*Kërkojmë që të merren parasysh kërkesat tona si pasqyrim i plotë i mungesës së barazpeshës në prokurime dhe modifikimin e specifikimeve për pjesmarrje të të gjithë prodhuesve prestigjozë.*

*Besojmë se ankesa jonë është e argumentuar e bazuar në ligj dhe do të merret parasysh. [...]*

II.3. Në datën 24.07.2020, operatori ekonomik ankimues "BNT Electronics" sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e kritereve të kualifikimit. Në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:

*[...]Rrethanat e faktit:*

*Ne date 20/07/2020, Institucioni juaj, ne rolin e AK ka publikuar ne sistemin e APP-se proceduren e prokurimit me objekt: "F.V Pajisje mjekesore -CT Scanner", ku eshte parashikuar te zhvillohet ne date 12/08/2020.*

*Bazuar ne Ligji Nr. 9643 date 20/11/2017 " Per Prokurimit Publik" Neni 63, pika 1.1 ku parashikon: Ne rastin e ankesave per dokumentet e tenderit, operatoret ekonornike mund te ankohen prane autoritetit kontraktor brenda 7 diteve nga data e publikimit te njoftimit te*

*kontrates ne faqen ne internetit te Agjencise se Prokurimit Publik, BNT Electronics shpk ankimon sot ne date 24/07/2020, brenda afatit te parashikuar per same poshte:*
*Pasi u njohem me kriteret kualifikuese dhe Specifikimet Teknike te paraqitura ne Dokumentat Standarte te Tenderit per pajisjet object prokurimi, konstatuam se kriteret dhe specifikimet pecifikimet teknike per produktin jane parashikuar ne kundershtim te hapur me Ligj in e Prokurimit Publik dhe ne kundershtim me rregullat e prokurimit publik.*
*Fillimisht ju informojme se firmat prodhuese kryesore ne fushen e prodhimit te skanerave jane kater: Canon, Philips, Siemens dhe GE. Te gjitha prodhojne pajisje pothuajse ne te njejtin nivel por qe kane disa specifikimet te tyre te ndryshme nga njera tjetra dhe qe per pasoje bejne dallimin.*
*Ne rastin konkret, nenvizojme faktin se pasi analizuam me kujdes specifikimet teknike te pajisjeve skanera, konstatuam se per te dy modelet e skanerave ( Skaner 16-slice dhe skaner 64 slice) i perkasin nje produkti /brandi te caktuar, konkretisht brandi General Electric Healthcare. Referim ky ne nje produkt dhe brand te caktuar, ne kundershtim te hapur me Ligjin e Prokurimit Publik, neni 23, pika 5 ku parashikon: Specifikimet teknike nuk duhet të kene asnje kerkese apo reference te ndonje marke apo emer i vecante, patente, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipermarres sherbimi, pervec rasteve kur nuk ekziston nje menyre e mjaftueshme, e sakte apo e kuptueshme, e pershkrimit ti! kerkesave, me kusht qi!fjalet "ose ekuivalent" ti! perfshihen detyrimisht ne keto specifikime.*
*Perkatesisht kerkoni prokurimin e pajisjeve: PAJISJE SKANER 16 SLICE Ge discovery RT dhe SKANER 64 SLICE Ge evolution EVO Me poshte po ju paraqesim ankesen tone lidhur me specifikimet teknike te cilat i perkasin nje produkti te vetem.*
*Per pajisjen Skaner 16 Slice eshte kerkuar:*
*Diapazoni i gjeresise se prerjes ,mm; nga ≤ 0.7 deri ≥ 5 mm & Minimumi i trashesise se prerjes, mm ≤ 0.625mm.*
*Keto dy specifikime ne kete kerkese, kundershtojne njera tjetren. Nuk mund te arrihet kushti: minimum i trashesise se prerjes ≤ 0.625mm nese kerkohet paraprakisht: Diapazoni i gjeresise se prerjes nga≤ 0.7 deri ≥ 5 mm.*
*Kerkojme modifikimin e kesaj kerkese duke e bere ate gjitheperfshires: Diapazoni i gjeresise se prerjes*
*,mm nga ≤ 0.76 deri ≥ 5 mm & Minimumi i trashesise se prerjes, mm ≤ 0.76mm.*

*Koha maksimale e nje rrotullimi 360°, sekonda >=4 sec.*
*Duket qarte se specifikimet jane bere per nje model ne nivel teknik shume te ulet skaneri ne cilin koha maksilmale eshte shume e gjate. Ne skanerat e gjeneratave te reja koha e rrotullimit tenton te jete sa me e ulet per dy arsye:*

*1. Kohe sa me e shkurter e skanimit zvogelon artefaktet qe shkaktohen si rezultat i pacientit.*
*2. Perfundimi i skanimit ne nje kohe mete shkurter rrit konfortin tek pacienti, i cili mund te jete klastrofobik.*

*Per sa me siper kerkojme: te hiqet kjo kerkese teknike ose te ndryshohet ne: koha maksimale e rrotullimit ne 360 grade te jete 1.5 sekonda e siper. Ne kete menyre specifikimet e tenderit jane mete hapura ne drejtim te konkurences.*

*Numri i opsioneve per zgiedhjen e kohes per nie rrotullim 360° ≥ 8*
*Ky specifikim Teknik ka te beje me zgjidhjen teknoligjike qe ka preferuar prodhuesi i pajisjes por qe nuk nuk ka aspak ndikim ne ekzaminimin klinik te pacientit. Pra nuk ka aspak lidhje te drejteperdrejte me natyren dhe performance qe duhet te arrije kjo pajisje. Duke qene se ka te beje me zgjidhjen teknologjike qe perdor prodhuesi, atehere automatikisht ky specifikim teknik ccon ne perjashtimin e mundesise se pjesemarrjes se gjere te operatoreve ekonomik te cilit mund te ofrojne pajisje nga prodhues qe kane zgjedhur teknologji tjeter ne te shumten e rasteve edhe mete mire se teknologjia qe ju i jeni referuar, keshtu duke mos lejuar nje procedure prokurimi te jete e hapur dhe konkuruese.*
*Qellimi dhe fokusi ne specifikimet teknike duhet te jete i tille qe te mundesojne permiresimin e kushteve te egzaminimeve klinike dhe jo ne zgjidhjen teknlogjike qe jep nje prodhues i vecante.*
*Kerkojme qe kjo kerekese te hiqet ose te modifikohet ne: numri i opsioneve te perzgjedhjes se kohes se rrotullimit te jete ne 6 e siper.*
*Monitor i integruar ne gantrv per paragitjen e te dhenave te pacientit dhe kontroll te pozicionimit me ane te prekies ne monitor.*
*Paraqitja e te dhenave te pacientit behet ne konsolen kompjuterike dhe nuk eshte e nevojshme te behet me ane te nje monitori tek Gentri, a mund te na thoni kush eshte perfitimi klinik ne kete rast?*
*Gjithashtu kontrolli i pozicionimit te pacientit behet me ane te butonave te komandimit ne te dy krahet e gentrit ne disa raste edhe me ndihmen e pedaleve pasi eshte zgjidhje me e mire se pozicionimi me ane te monitorit me prekje per pozicionim te pacientit arsyet:*
*l.Monitori me prekje eshte me i prirur te japi difekte ndersa butonat e komandimit jane mete mbrojtur dhe kane jetegjatesi mete la rte.*
*2.Ne kushte e skanerave te urgjences mundesia e goditjes se ekranit dhe demtimit eshte me larte dhe moskalibrimi i touchscreen gjithashtu dote paralizonte punen.*
*Per sa me larte kerkojme:*
*te hiqet kerkesa per monitorin te Gantry*
*te modifikohet kerkesa per kontrollin e pozicionimit duke e bere ate: komandim te pozicionit nepermjet butonave.*
*Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera nominale, pa permiresim nga softueri), MHU ≥ 6 MHU*
*Kapaciteti i nxehtesise maximale i llampes se rrezeve eshte pak i rendesishem pasi ne ditet e sotme perdoren skanera me kapacitet nxehtesie mete ulet por qe kryejne rikonstruksione perseritese (iterative reconstruction) dhe kane doze rrezatimi mete ulet.*
*Fuqia e nevojshme rrezatimit eshte me e ulet dhe detyrimisht kapaciteti i nxehtesise synohet te jete me i ulet ne rast kur perdoren teknika te avancuara rikonstruksioni.*
*Kerkojme qe kjo kerkese te hiqet ose te ndryshohet ne: kapaciteti ngrohes i anodes te jete 5 MHU e siper.*
*Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja) mA ≥ 840kHU/min*

*Edhe kjo kerkese teknike njesoj site tjrat eshte perjashtuese per operatoret e tjere te mundshem. Ne kete kerkese teknike mund te perdoret nje vlere me e vogel pasi dhe me nje vlere mete vogel si 760kHU/min nuk cenohet ëorkfloë.*
*Per same larte, kerkojme te ndryshohet kjo kerkese teknike duke u bere: Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja) mA ≥ 760kHU/min.*

*Intensiteti i rrymes vlera ekuivalente, me permiresim nga softueri), mA ≥ 725 mA Intesiteti i rrymes varet nga fuqia dhe lloji i gjeneratorit te rrezeve X dhe intesiteti i rrymes nuk mund te rritet me ane te licences se nje softi te vecante.*
*Programe te avancuara te rikonstruksionit dhe permiresim i elementeve te detektorit bejne te mundur uljen e intesitetit te nevojshem te rrymes.*
*Kjo kerkese eshte kontradiktore dhe e paarsyetuar. Nga njera ane kerkohet permirsim i softëare nga ana tjeter kerkohet rritja e rrymes.*
*Per sa me siper kerkojme: te hiqet kjo kerkese nga specifikimet teknike.*
*Fugia, kË (vlera ekuivalente, me permiresim nga softueri) ≥ 85 kË*
*Kjo kerkese teknike nuk ka absolutisht vend per zbatim. Te gjithe specialistet e fushes jane ne dijeni te faktit se fuqia maxima lee gjeneratorit nuk mund te rritet me ane te nje licence softi.*
*Gjithashtu kjo kerkese eshte kontradiktore me specifikimet e kerkuara ne teresi, sepse nga njera ane kerkoni rrotullime te gantry jo te shpejta, programe rikonstruksioni qe ulin dozen e rrezatimit, eleminojne zhurmat dhe nga ana tjeter kerkoni rritje te fuqise se gjeneratorit.*
*Rrotullimet e shpejta te rotorit te gantry-it kerkojne gjenerator me fuqi mete la rte ndersa perdorimi i rikonstruksioneve te avancuara ben te mundur uljen e dozes dhe detyrimisht kerkon nje gjenerator me fuqi me te vogel.*
*Per sa me siper, kerkojme te hiqet nga specifikimet teknike kjo kerkese.*
*Diapazoni ne dispozicion, kV nga s ≤ 80 deri ne ≥ 140 Kv.*
*Vlerat e kerkuara te specifikimeve jane te parsyetuara dhe te marra Copy/Paste ne internet.*
*Ne ditet e sotme synohet zvogelimi i dozes se rrezatimit tek pacienti dhe detyrimisht ulja e parametrave qe kane te bejne me rrezatimin si kV,mA, sec apo mAs. Ju nuk mund te ngeleni peng i specifikimeve te marra dhe te vendosura copy/paste ne dokumentat e tenderit dhe pa asnje arsyetim llogjik/teknik.*

*Vlerat kV te kerkuara paraqesin thjesht vlerat e "peak-ut" dhe nuk paraqesin spektrin efektive rrezatimit te perdorur, ky i fundit varet nga "ëedge"(sinjali i kalibrimit) i perdorur. Doza e rrezatimit te perdorur varet nga "ëedge" dhe jo nga kV peak te zgjedhur.*

*Prodhuesit e njohur nderkombetarisht ofrojne zgjidhje mjaft here me te mira ne perzgjedhjen e kV te nevojshem ne menyre automatike ne varesi te permasave te pacientit dhe detyrave klinkave te kerkuara.*

III.1.4. Në nenin 27, pika 1 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet se "*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPPdhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara".*

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. KPP thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma "b" dhe "c" e LPP-së), janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustifikuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vemendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të

pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 23 të LPP-së, KPP gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar tre metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me referimin e standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. Metoda e dytë e hartimit të specifikimeve teknike lidhet me referimin e kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale. Gjithashtu, edhe metoda e tretë, e cila është një ndërthurje e dy metodave të mësipërme, por çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj". Autoritet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 "Për prokurimin public" KE, parashikohet se: *" Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohet për një punë, shërbim ose furnizim"* Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cështja C-368/10 *"Komisioni Europian vs. Mberëtëria e Hollandës" inter allia* dhe *mutatis mutandis* është arsyetuar se: *"Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe, kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, oferutesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese."*

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 63 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për*

*prokurimin publik”* të ndryshuar ku parashikohet se: *”Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendojsen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (*qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit*), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson se, fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhues vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht *sine qua non* se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së proves referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “ në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion.

III.1.6. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se *“Ka nje diskordance te madhe midis vlerave te kerkuara te fuqise se gjeneratorit te rrezeve X (pa/me permirësim nga sofëëare) te CT Scanner 64 slice me CT Scanner 16 slice. Me saktesisht ne CT Scanner 64 slice nga ana e AK kerkohet ≥ 48 kË/250 kË ndersa ne CT Scanner 16 slice kerkohet ≥ 50kË/85kË. Eshte pa kuptim qe ata te kerkojne vlera me te uleta te gjeneratorit per nje CT Scanner 64 slice ne raport me CT Scanner 16 slice. Nga ana tjeter vlerat e kerkuara ne specifikimet teknike te fteses per oferte qe paraqiti AK, ishin fillimisht ≥ 55Kë (per CT Scanner 64 slice), nderkohe qe me pas kjo vlere u tkurr dhe u vendos pa asnje logjike ≥ 48kË. Sipas arsyetimit tone, ky fenomen ndodhi ne rastin me te mire si nje konfuzion i shkaktuar nga mungesa e pervojes ne hartimin e specifikimeve teknike te ketij lloji pajisjesh dhe ne rastin me te keq si nje tendence per te coroditur dhe hutuar pjesemarresit ne kete gare duke vendosur fuqine e gjeneratorit te nje prodhimi nqa nje kompani e Lindjes se Larget thjesht e vetem per te "kembengulur" që specifikimet teknike nuk jane te nje prodhimi te perfaqesuar nqa shoqeria “Montal” sh.p.k., por jane te hapura per shume prodhues. Ne pergjigjen e tij, Autoriteti Kontraktor, per fuqine e gjeneratorit te rrezeve X per CT Scanner 64 slice nuk shprehet fare ne nje kohe qe vlerat jane mjaft te cuditshme dhe jo ne raport normal teknik me kerkesat e gjeneratorit te CT Scanner 16 slice..,* Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa

përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të përcaktojë në lidhje me pajisjet (CT Scanner slice16 slice 64 ) specifikime teknike dhe vlera të ndryshme për dy pajisje të ndryshme pasi secila pajisje është individuale dhe përmban vlerat/parametrat e tij. Akoma më tej KPP gjykon se referuar seancës dëgjimore të zhvilluar si dhe pretendimeve të ngritura nga operatori ekonomik ankimus gjykon se ky i fundit nuk ka sjellë asnje argument teknik apo ligjor për të provuar apo mbështetur pretendimin e tij. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të vendosë ato specifikime teknike për pajisjet objekt prokurimi të cilat nuk bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe nenit 27, pika 6 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se specifikimi i mësipërm, në tërësinë e tij, në lidhje me specifikën e procedurës së prokurimit është në përputhje me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit parashikuar nga neni 2 gërma "a", në drejtim të mos diskriminimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.1.6.1. Lidhur me pretendimin se *"2. Ne specifikimet e hartuara nga AK, vihen re: Hapat e kerkuara te rregullimit te tensionit jane ≤ 80 deri ne ≥140 kV gje qe eshte tipike e prodhimit REVOLUTION EVO GEN 2. Pse nuk eshte kerkuar ≤ 70 deri ne ≥140 kV sepse kjo ben te mundur edhe hartimin e mjaft protokolleve me doze te ulet ? Apo nuk e ploteson prodhimi i REVOLUTION EVO GEN 2 ? Ne pergjigjen e tij, Autoriteti Kontraktor ne vend qe te ule pjesen e poshtme te brezit (pra te beje 70 kV ne vend te 80 kV ne menvre qe te kete protokolle me sa me pak doze) ..... cfare ben ne fakt ? Thjesht ul pjesen e siperrne te brezit nga 140 kV ne 135 kV !! !! !! E kuptueshme nga kushdo per te mos prishur pune produktit te parazgjedhur.* ", Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.6.2. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar ankimuesit për trajtimin e ankesës së paraqitur prej tij, argumenton se*: "[...]Lidhur me kerkesen: Ne lidhje me specifikimin: Diapazoni ne dispozicion, kV nga ≤ 80 deri ne ≥140 kV. OE kerkon qe ky specifikim te behet nga ≤ 70 deri ne ≥ 140 kË. AK pasi beri verifikimet perkatese konstatoi se pergjithesisht ky specifikim plotesohet nga pajisjet e ngjashme te prodhuesve te ndryshem por gjithashtu konstaton se prodhues te ndryshem per kete kategori kane devijime te vogla ne lidhje me diapazonet e tensioni apo rrymes. Nisur nga moscenimi i cilesise nga keto devijime te vogla ne diapazonin e rrymes, AK vendos qe pretendimi i OE qendron pjeserisht dhe ben modifikimin si me poshte:*

*Ishte*
*Diapazoni ne dispozicion, kV nga ≤ 80 deri ne ≥ 140 kV,*
*Behet*
*Diapazoni ne dispozicion, kV nga ≤ 80 deri ne ≥135 Kv"*

Për artikullin "Scanner Ct 64 Slices":

*Ishte:*
*Diapazoni në dispozicion, kV nga ≤ 80 deri në ≥ 140 kV*
*Bëhet:*
*Diapazoni në dispozicion, kV nga ≤ 80 deri në ≥ 135 kV*

Në datën 27.08.2020 në vijim të deklarimeve të seancës dëgjimore, autoriteti kontraktor me anë të komunikimit elektronik me e-mail ka dorëzuar sqarime shtesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik ku ka argumentuar se: *"[...]Përsa i përket kërkesave të OE për diapazonin e tensionit të Gjeneratorit të rrezeve X, për të dy modelet CT Scanner (16 dhe 64 slices), AK sqaron:*
*Fillimisht është kërkuar minimum i diapazonit të tensionit 80 – 140 kV te cilin e plotësojnë shumë prodhues, madje disa prej tyre e fillojnë nga 70 kV e arrijnë deri në 140 kV. Pas kërkesave nga disa operatorë, per të mundësuar një pjesëmarrje edhe më të gjerë, është ulur edhe më tepër kërkesa për diapazonin e tensionit nga ≤ 90 deri ne ≥ 135 kV për CT Scanner 16 slices dhe diapazonin nga ≤ 80 deri ne ≥ 135 kV për CT Scanner 64slices. Rrjedhimisht, me ndryshimin e lejuar mundësohet kualifikimi i atyre kompanive që e kanë maksimumin ≥135 kV, ato me 140 kV apo më tepër. Për analogji, kualifikohen edhe produktet që tensionin minimal e kanë ≤ 90 kV, ≤ 80 kV apo edhe ≤ 70 kV. [...]"*

III.1.6.3. Në lidhje me këtë pikë Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se referuar sqarimeve të autoritetit kontraktor në informacionin e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik ky i fundit konstaton se autoriteti kontraktor ka shfaqur paqartësi në sqarimin e tij. Në këtë kupim KPP gjykon që autoriteti kontraktor të qartësojë dhe përcaktojë specifikimin teknik në lidhje me këtë pretendim. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se sa më sipër, autoriteti kontraktor, duhet të bëjë sqarimet përkatëse, lidhur me faktin që çdo operator ekonomik i interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, të jetë i qartë në lidhje me specifikimet teknike që duhet të përmbushë produkti që kërkohet. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues si edhe sqarimeve të dhëna nga ana e autoritetit kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor, referuar sqarimeve ka pranuar se referuar *analogjisë* se edhe produktet me parametrat e propozuara nga ana e operatorit ekonomik ankimues përmbushin specifikimet teknike e për rrjedhojë do të kualifikohen. KPP nënvizon se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e këkresave dhe detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve, parashikuar në nenin 2 gërma "c" të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik"* të ndryshuar. Për rrjedhojë, KPP gjykon se autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 42 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik"* të

ndryshuar duhet të pasqyrojë sqarimet e nevojshme ose të ndryshojë specifikimin e mësipërm, duke pasqyruar deklarimet e dhëna nga vetë ky i fundit.

III.1.6.4. Lidhur me pretendimin se *"3. I kerkuam AK arsyen pse duhet te vendosen vlera abuzive 250 kw me permiresimin nga softwear? Ku mund te matet ky permisim ? Po prodhime te tjera qe kane përmirësime te tipeve te tjera pse nuk jane pasqyruar? Ky parameter duhet hequr si mjaft teorik dhe aspak i matshem dhe duhet fshire. Ne pergjigjen e tij AK nuk shprehet fare per kete vlere*", Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: Autoriteti kontraktor ka marrë në konsideratë ankesën e operatorit ekonomik ankimues duke bërë njëherazi edhe ndryshimet përkatëse në speficikimet teknike të cilat janë të publikuara në shtojcë. Konkretisht citoj:
***<u>Ishte:</u>***
*Fuqia, kw (vlera ekuivalente, me përmirësim nga softueri) ≥ 250 kw,*
***<u>Bëhet:</u>***
*Fuqia, kw (vlera ekuivalente, me përmirësim nga softueri) ≥ 120 kw,*

Sa më sipër në lidhje me shqyrtimin që autoriteti kontraktor i ka bërë këtij pretendimi të operatorit ekonomik ankimues, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka pranuar këtë pretendim duke u shprehur se ky pretendim qëndron. Dhe ka bërë saktësimin përkatës në lidhje me pretendimin. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se pretendimi i mësipërm është pranuar nga ana e autoriteti kontraktor dhe në lidhje me këtë të fundit nuk ka më objekt ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Në zbatim të këtij vendimi autoriteti kontraktor ka pasqyruar njëherazi edhe ndryshimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit për aq sa është pranuar prej autoritetit kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike.

Si rrjedhim ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim

III.1.6.5. Lidhur me pretendimin se *"Tubi i Rrezeve X. Ne parametrat e llambës se Rontgen-it specifikimet teknike te AK vendosin perseri ne nivele vlerash ku prodhimi i REVOLUTION EVO GEN 2 te ndihet komod. Me saktesisht: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera nominale, pa permiresim nga softëeri), MHU kerkohet 7 MHU qe eshte perseri fotokopje e REVOLUTION EVO GEN 2. Pse valle nuk kerkohet 8 MHU kur ka disa kompani qe e kane te tille, apo kjo e vendos REVOLUTION EVO GEN 2 ne veshtiresi? Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja) eshte ≥1000 kHU ne nje kohe qe GE e ka 1070 !! !! Pse nuk vendoset vlera e largimit te nxehtesise ≥ 1600 kHU apo kjo e vendos REVOLUTION EVO GEN ne veshtiresi? Fokusi i vogel dhe i madh jane perseri zgjidhje teknike dhe vlerat jane vendosur qe REVOLUTION EVO GEN 2 te jete komode. Ato shumë mire mund te ishin 0.5/1 dhe do kishin nje impakt mjaft te mire ne rezo/ucion hopesinor. Pse nuk jane vendosur te tilla ? Apo sepse nuk i ploteson REVOLUTION EVO GEN 2 ?Edhe ketu AK nuk jep asnje lloj shpjegimi apo sqarimi ne lidhje me ankesën tonë.*",

Referuar seancës dëgjimore të zhvilluar sa më sipër sqaruar, Komisioni i Prokurimit Publik ka kerkuar sqarime lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik se specifikimet teknike janë drejtuar drejt një

produkti, dhe kërkohet ndryshimi i tyre, në: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera nominale, pa permiresim nga softueri), MHU është kërkuar ≥ 8 MHU si edhe Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja) ≥ 1600 kHU, si dhe mbi bazen e cilit standard kombetar ose nderkombetar i bazon pretendimet.

Në lidhje me pretendimin për rritjen e kapacitetit nga 7 në 8 MhU Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, operatori ekonomik ka parashtruar pretendime për shtim kriteresh. KPP gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 19/1 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 12 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 63 pika 1.1. të LPP-së, parashikohet se "Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik".

KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve (legitimation ad causam), pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cënuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kritereve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurat për fitimin e kontratave publike, do t'i nënshtrohen kushteve specifike (kritereve të veçanta të kualifikimit), të cilat duhet të përmbushin parakushtin sine qua non të parashikuar nga neni 46 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, duke qenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit) duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar. Kompentenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku në nenin 63 pika 4 gërma "b" të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknike janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kritereve kualifikuese/specifikimeve teknike në një procedurë prokurimi. Sa më sipër, KPP

gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia proceduriale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.
Sa më sipër, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kritere të tjera kualifikuese/specifikime teknike për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik, e rrjedhimisht, pretendimi i mësipërm nuk qëndron.

III.1.6.6. Lidhur me pretendimin se *"Gantry. Pjerresimi (real, jo digital), grade+/- 30. Kerkojme te behet +/- 24 grade sepse prish konkurrencen. Ne ditet e sotme skanerat po pjerresohen gjithmone e me pak per shkak te pranise se rikonstruksioneve te cilat e kryejne me shpejt ekzamionimin dhe operatori nuk humbet kohe te cmuar duke bere levizje gjeometrike te CT Scanner-it. Ne kete optike synimi eshte thjesht qe te perjashtohen me një menyre ose nje tjeter kompani te cilat mjaft prestigjioze vetem nepermjet luftes se numrave nga kompania "Montal" sh.p.k.*", Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III. 1.6.7. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar ankimuesit për trajtimin e ankesës së paraqitur prej tij, argumenton se*: "[...]Ne lidhje me ankesen e OE per specifikimin: Pjerresimi (real, jo digital), grade ± 30° ku kerkoni qe kjo pjerresi te jete me e vogel, AK pasi beri verifikimet perkatese konstatoi se prodhuesit kane kategori te ndryshme te pajisjeve dhe nga verifikimet e bera rezultoi se ky specifikim plotesohet nga kategorite e ngjashme te pajisjes objekt i kesaj procedure prokurimi te prodhuara nga prodhues te ndryshem. Ankesa e OE nuk qendron."*

III. 1.6.8. Referuar seancës dëgjimore të zhvilluar sa më sipër sqaruar dhe sqarimeve te dhena nga autoriteti kontraktor dhe operatoret ekonomike ankimues qe i sherbyen Komisionit te Prokurimit Publik per te krijuar bindjen mbi elementet konkrete dhe rendesine e ketij specifikim teknik, KPP konstatoi se referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues Komisioni i Prokurimit Publik del në përfundimin se operatori ekonomik ankimues nuk ka arritur të provojë se në c'mënyrë ky parametër arrin të cënojë konkurrencën. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknikë kufizues e përjashtues, por duhet të përcaktojë parametra minimalë me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar një diapazon të gjerë parametrash duke mos kufizuar konkurrencën, por duke lejuar një pjesëmarrje sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.1.6.9. Lidhur me pretendimin se *“Numri total i elementeve te detektorit. Numri i kerkuar prej 54,000 tregon fare qarte qe ky specifikim eshte kopjuar nga katalogu i REVOLUTION EVO GEN 2. Aty shprehet qe numri i elementeve eshte pak me i madh se sa 54,000 dhe mënyra se si eshte vendosur tregon fare mire dhe fare qarte tendencen e hartuesve te specifikimeve teknike. Zgjidhja teknologjike e prodhuesve te tjere nuk ka nevoje per kaq shurne elemente sepse kane teknologji te tille qe me me pak elemente marrin te njejtin rezultat, madje edhe me te mire? Mos valle ka pasur ndonje ent spitalor ne SH.B.A apo BE ndonje pretendim per numrin e elementeve te detektorit per prodhues te tjere etj ?.*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: Autoriteti kontraktor ka marrë në konsideratë ankesën e operatorit ekonomik ankimues duke bërë njëherazi edhe ndryshimet përkatëse në speficikimet teknike të cilat janë të publikuara në shtojcë. Konkretisht citoj:

*Ishte*

*Numri total i elementeve të detektorit ≥ 54,000*

***<u>Bëhet:</u>***

*Numri total i elementeve te detektorit ≥ 47,000.*

Sa më sipër në lidhje me shqyrtimin që autoriteti kontraktor i ka bërë këtij pretendimi të operatorit ekonomik ankimues, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka pranuar këtë pretendim duke u shprehur se ky pretendim qëndron. Dhe ka bërë saktësimin përkatës në lidhje me pretendimin. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se pretendimi i mësipërm është pranuar nga ana e autoriteti kontraktor dhe në lidhje me këtë të fundit nuk ka më objekt ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Në zbatim të këtij vendimi autoriteti kontraktor ka pasqyruar njëherazi edhe ndryshimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit për aq sa është pranuar prej autoritetit kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike.

Si rrjedhim ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim

III.1.6.10. Lidhur me pretendimin se *“Shtrati i pacientit. Kerkohet nje peshembajtje ≥ 225 kg nderkohe qe REVOLUTION EVO GEN 2 e ka 227 kg. Mos valle eshte nje rastesi ? Apo kaq e ka REVOLUTION EVO GEN 2? Eshte rastesi qe ne nje vend mesdhetar si Shqiperia qe nuk ka nje shkalle kaq te larte obeziteti te vendoset ky parameter? Mos vallë kemi nivel obeziteti sa ne vendet e tjera te Evropes Veriore dhe Atlantikut te Veriut? Nuk kemi pare deri me sot nje shqiptar qe te jete me shumë se 170 kg. Vlera qe mund te vendoset mund te jete jo me e mad he se 200 kg. Autoriteti kontraktor gjykoi ne pergjigjen e tij qe kapaciteti peshembajtes i shtratit mund te bëhet 220 kg ne nje kohe qe paciente te tille nuk ka per te patur ndonjëhere dhe nuk shqetesohet aspak qe te vendosë nje kusht mjaft te thjeshte dhe mjaft aktual, sidomos ne kohen qe jetojmë. Pra, Kontroll te plote ne distance te shtratit te pacientit per te minimizuar kontaktin e operatorit me pacientin e semure. Pse nuk vendoset? Apo sepse nuk e ploteson REVOLUTION EVO GEN 2 ??.*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: autoriteti kontraktor ka pranuar ankesen e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe ka bere modifikimet perkatese ne specifikimet teknike duke publikuar shtojcën përkatëse si më poshte:

***<u>Ishte:</u>***

*Kapaciteti i peshës së shtratit, kg ≥ 225 kg*

***Bëhet:***

*Kapaciteti i peshës së shtratit, kg ≥ 220 kg*

III.1.6.11. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, dhe 1.1. dhe 6, të Ligjit nr.9643, datët.20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku është parashikuar shprehimisht se: "Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin." "Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik." Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: "Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor."
Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky është një pretendim i ri, i ngritur rishtazi në KPP, sqarojmë se nuk do të merret në shqyrtim pasi nuk ka respektuar rrugën e ezaurimit të ankimimit në autoritetin kontraktor në kuptim të nenit 63 të LPP. Ndërkohë që operatori ekonomik ankimues, ka patur në dispozicion momentin procedurial në lidhje me kundërshtimin e modifikimit të kryer nga autoriteti kontraktor, në respekt të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimet nuk merren në shqyrtim.

III.1.6.12. Lidhur me pretendimin se *"Performanca. Ketu shpaloset teresisht fotokopja e paster e vlerave te REVOLUTION EVO GEN 2 te cilat jane si me poshte vijon :*
*Boshti X-Y*
*- @SO: 12.1 Ip/cm*
*-@10%: 16 Ip/cm*
*- @4%: 18.3 Ip/cm*
*- @0% > 18.3 Ip/cm*
*Mendojme se komentet jane te teperta. Madje AK as ka marrë mundimin qe te marrë ne konsiderate per ta shqyrtuar kerkesen tonë!!!*", Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:
III.1.6.13. Lidhur me këtë pretendim, konstatohet se operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo argumenta të bazuara, por ngre pretendime a-priori dhe të përgjithshme në lidhje me kërkesat e mësipërme. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas

juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimimit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 20, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3, gërma “a”-Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;” Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.012.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra autoriteti kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e autoritetit kontraktor dhe të hartojë e argumentojë të gjitha kriteret e procedurës së prokurimit në themel. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për hartimin jo të saktë të kritereve kualifikuese. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për hartimin e kritereve të mësipërme në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, pesha specifike e barrës për të provuar hartimin e dokumentave të tenderit në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues se cilat kritere/specifikime teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë të gabuara apo diskriminuese.

Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të dokumentave të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një quasi gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

III.1.6.14. Lidhur me pretendimin se *“CT Console - Kapaciteti Rindertues. Kerkohet matricë rindërtimi 512x512. Pse nuk kerkohet një matricë 1024x1024? Apo nuk plotesohet nga Revolution evo gen 2? Nese do te mbetet 512x512 atehere te behet shpejtesia e ndertimit te imazheve 40 imazhe/sek”* , si dhe pretendimin se *“Stacion pune (ëorkstation) i pavarur për përpunim të mëtejshëm “post processing”. Pse nuk kërkohen MIP (Maximum Intensity Projection), surface MIP,MiniIP, vip ( volume intensityProjection) Volume rendering ?* ”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: operatori ekonomik ka parashtruar pretendime për shtim kriteresh. KPP gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 19/1 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 12 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e

kritereve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 63 pika 1.1. të LPP-së, parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik”.

KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve (legitimation ad causam), pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cënuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kritereve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurat për fitimin e kontratave publike, do t’i nënshtrohen kushteve specifike (kritereve të veçanta të kualifikimit), të cilat duhet të përmbushin parakushtin sine qua non të parashikuar nga neni 46 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, duke qenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit) duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Kompentenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku në nenin 63 pika 4 gërma “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknike janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kritereve kualifikuese/specifikimeve teknike në një procedurë prokurimi. Sa më sipër, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia proceduriale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kritere të tjera kualifikuese/specifikime teknike për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik, e rrjedhimisht, pretendimi i mësipërm nuk qëndron.

III.1.5.15. Lidhur me pretendimin se *"B. CT Scanner 16 slice Diapazon i gjeresise se prerjes, mm nga ≤ 0.7 deri ≥ 5 mm.*
*Eshte tipike e OPTIMA 540 16 slice. Per te pasur nje pjesernarrje sa me te gjere ju lutemi hapeni brezin ≤ 0.75 mm deri ≥ 5 mm. Autoriteti kontraktor madje shkon edhe e thellon edhe me tej mungesën e paanshmërisë duke e ulur edhe me tej ne 0.65 mm.",* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: autoriteti kontraktor pas ankimit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor ka gjykuar se, specifikimi teknik i vendosur nga autoriteti kontraktor do te ndryshohet, duke publikuar shtojcën përkatëse si më poshte:
Ishte:
Diapazon i gjerësisë së prerjes, mm nga ≤ 0.7 deri ≥ 5 mm,
Minimumi i trashësisë së prerjes, mm ≤ 0.625 mm,
Bëhet:
Diapazon i gjerësisë/trashësisë së prerjes, mm nga ≤ 0.65 deri ≥ 5 mm
Hiqet Specifikimi: Minimumi i trashësisë së prerjes, mm ≤ 0.625 mm.

III.1.6.16. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, dhe 1.1. dhe 6, të Ligjit nr.9643, datët.20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku është parashikuar shprehimisht se: "Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin." "Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik." Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: "Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor."
Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky është një pretendim i ri, i ngritur rishtazi në KPP, sqarojmë se nuk do të merret në shqyrtim pasi nuk ka respektuar rrugën e ezaurimit të ankimimit në autoritetin kontraktor në kuptim të nenit 63 të LPP. Ndërkohë që operatori ekonomik ankimues, ka patur në dispozicion momentin procedurial në lidhje me kundërshtimin e modifikimit të kryer nga autoriteti kontraktor, në respekt të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimet nuk merren në shqyrtim.

III.1.6.17. Lidhur me pretendimin se *"Monitor i integruar ne gantry per paraqitjen e te dhenave te pacientit dhe kontroll te pozicionimit me ane te prekjes ne monitor. U kerkua te hiqet si specifikim sepse nuk ka asnje lloj kuptimi dhe eshte mjaft specifik dhe i tepruar.*

*Nuk perben asnje lloj perftimi dhe eshte nje specifikim qe e perrnbush vetem OPTIMA 540 16 slice.* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: Autoriteti kontraktor ka marrë në konsideratë ankesën e operatorit ekonomik ankimues duke bërë njëherazi edhe ndryshimet përkatëse në speficikimet teknike të cilat janë të publikuara në shtojcë, si më poshtë vijon:

*Ishte:*
*Monitor i integruar në gantry për paraqitjen e të dhënave të pacientit dhe kontroll të pozicionimit me anë të prekjes në monitor kërkohet Të përfshihen në oferte, përshkrim i detajuar*
*Bëhet:*
*Monitor i integruar në gantry për paraqitjen e të dhënave të pacientit dhe kontroll të pozicionimit me prekje ose butona kërkohet Të përfshihet në ofertë, përshkrim i detajuar.* Sa më sipër në lidhje me shqyrtimin që autoriteti kontraktor i ka bërë këtij pretendimi të operatorit ekonomik ankimues, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka pranuar këtë pretendim dhe ka bërë saktësimin përkatës në lidhje me pretendimin.
Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, dhe 1.1. dhe 6, të Ligjit nr.9643, datët.20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku është parashikuar shprehimisht se: "Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin." "Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik." Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: "Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor."
Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky është një pretendim i ri, i ngritur rishtazi në KPP, sqarojmë se nuk do të merret në shqyrtim pasi nuk ka respektuar rrugën e ezaurimit të ankimimit në autoritetin kontraktor në kuptim të nenit 63 të LPP. Ndërkohë që operatori ekonomik ankimues, ka patur në dispozicion momentin procedurial në lidhje me kundërshtimin e modifikimit të kryer nga autoriteti kontraktor, në respekt të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimet nuk merren në shqyrtim.

III.1.6.18. Lidhur me pretendimin se "*Ne kete drite iu shpjegua Autoritetit kontraktor edhe per Kapacitetin ngrohes te Anodes (vlera nominale, pa permiresim nga softëeri), 6 MHU ... Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja) 750 kHU. Eshte mjaft qesharak fakti qe per CT Scanner 64 slice vendosen parametra te ulet te llambës kurse ketu kerkohen te larte per nje CT 16 slice ...*

*??? Mos valle eshte rastesi dhe gabim njerezor apo eshte tendence e hapur per te perzgjedhur OPTIMA 540 16 slice??? Per te hapur specifikimet kerkuarn qe te vendoset ≥5 MHU dhe 700 kHU........Autoriteti ndersa merr parasysh Kapacitetin dhe e ndryshon nga 6 ne 5 MHU ..... nuk e zbret edhe Largimin e nxehtesise se Anodes po ne te njejtin raport por e zbret mjaft pak nga 840 e ben 800 kHU.* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: Autoriteti kontraktor ka marrë në konsideratë ankesën e operatorit ekonomik ankimues duke bërë njëherazi edhe ndryshimet përkatëse në speficikimet teknike të cilat janë të publikuara në shtojcë. Konkretisht citoj:

**<u>Ishte:</u>**

Kapaciteti ngrohës i Anodes (vlera nominale, pa përmirësim nga softueri), MHU: ≥ 6 MHU,

**<u>Bëhet:</u>**

Kapaciteti ngrohës i Anodes (vlera nominale, pa përmirësim nga softueri), MHU: ≥ 5 MHU,

**<u>Ishte:</u>**

Largimi i nxehtësisë së Anodes (ftohja) ≥ 840 kHU/min

**<u>Bëhet:</u>**

Largimi i nxehtësisë së Anodes (ftohja) ≥ 800 kHU/min

Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, dhe 1.1. dhe 6, të Ligjit nr.9643, datët.20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku është parashikuar shprehimisht se: "Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin." "Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik." Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: "Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor."
Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky është një pretendim i ri, i ngritur rishtazi në KPP, sqarojmë se nuk do të merret në shqyrtim pasi nuk ka respektuar rrugën e ezaurimit të ankimimit në autoritetin kontraktor në kuptim të nenit 63 të LPP. Ndërkohë që operatori ekonomik ankimues, ka patur në dispozicion momentin procedurial në lidhje me kundërshtimin e modifikimit të kryer nga autoriteti kontraktor, në respekt të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimet nuk merren në shqyrtim.

III.2.1.17. Lidhur me pretendimin se *"2.Pjerresimi (real jo digital) grade. Duke qene se nje anim i gantry-t prej +/-25 grade permbush te gjitha qellimet klinike te perkuljes se gantry-t njesoj si +/-30 grade. Kerkojme qe ky specifikim te modifikohet duke u bere: Pjerresim (real, jo digital) grade +/-25grade.",* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1.18. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik në lidhje me pretendimin e mësipërm konstatoi se referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues Komisioni i Prokurimit Publik del në përfundimin se operatori ekonomik ankimues nuk ka arrit të provojë se në cmënyrë ky parametër arrin të cënojë konkurencën. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknikë kufizues e përjashtues, por duhet të përcaktojë parametra minimalë me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar një diapazon të gjerë parametrash duke mos kufizuar konkurrencën, por duke lejuar një pjesëmarrje sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.1.19. Lidhur me pretendimin me arsyetimin se *"3Pajisur me ekran per parametrat e skanimit dhe EKG. AK nuk eshte shprehur fare per kete pike ankese lidhur me kete specifikim tekenik. Ju lutem te na sqarohet: A eshte nevojshme monitorimi i zemres( gated ECG ) gjate procesit te skanimit te rikonstruksionit?",* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon që autoriteti kontraktor ne zbatim te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, neni 42 "Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit" ne te cilin parashikohet se :
"1. *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit",* duhet të qartësojë dhe përcaktojë specifikimin teknik në lidhje me këtë pretendim. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se sa më sipër, autoriteti kontraktor, duhet të bëjë sqarimet përkatëse, lidhur me faktin që çdo operator ekonomik i interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, të jetë i qartë në lidhje me specifikimet teknike që duhet të përmbushë produkti që kërkohet. Sqarojmë se, sa më sipër, autoriteti

kontraktor, duhet të bëjë sqarimet përkatëse, me faktin që operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, të jetë i qartë në lidhje me specifikimet teknike që duhet të përmbushë produkti që kërkohet.
Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2.1.20. Lidhur me pretendimin se *"4.Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera nominaLe, pa permiresim nga softueri), MHU ≥ 7 MHU Kapaciteti i nxehtesise maximal i llampes se rrezeve nuk eshte i rendesishem pasi ne ditet e sotme perdoren skanera me kapacitet nxehtesie mete ulet por qe kryejne rikonstruksion perserites (iterative reconstruction) dhe doze rrezatimi me te ulet.*
*Fuqia e nevojshme rrezatimit eshte me e ulet dhe detyrimisht kapaciteti i nxehtesise synohet te jete me i ulet ne rast kur perdoren teknika te avancuara rikonstruksioni.*
*Kerkojme qe kjo kerkese te hiqet ose te ndryshohet duke u bere: kapaciteti ngrohes i anodes te jete 5 MHU e siper.",* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1.21. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me këtë pikë qëndron, pasi referuar LPP-së autoriteti kontraktor duhet të hartojë secifikime teknike në mënyrë të tillë që të sigurohet minimumi i parametrave për pajisjet të cilat kërkon të blejë duke mos cenuar cilesinë dhe funksionalitetin e pajisjeve si dhe duke siguruar pjesmarrjen e një rrethi sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Nga ana tjetër autoriteti kontraktor në argumentimet e dhëna para KPP nuk ka argumentuar teknikisht se ndryshimi i specifikimit të mësipërm cënon funksionalitetin e pajisjes së mësipërme. Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e specifiimit teknik rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2.1.22. Lidhur me pretendimin se *"5.Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja) mA ≥ 1000 kHU/min. Gjykojme qe ne kete specifikim mund te perdoret nje vlere me e vogel ne menyre qe te mos jete specifike perjashtuese, pasi dhe me nje vlere mete vogel si 840kHU/min nuk cenohet ëëorkfloëë.",* Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me këtë pikë qëndron, pasi referuar LPP-së autoriteti kontraktor duhet të hartojë secifikime teknike në mënyrë të tillë që të sigurohet minimumi i parametrave për pajisjet të cilat kërkon të blejë duke mos cenuar cilesinë dhe funksionalitetin e pajisjeve si dhe duke siguruar pjesmarrjen e një rrethi sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Nga ana tjetër autoriteti kontraktor në argumentimet e dhëna para KPP nuk ka argumentuar teknikisht se ndryshimi i specifikimit të mësipërm cënon funksionalitetin e pajisjes së mësipërme. Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e specifiimit teknik rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.
Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e specifiimit teknik rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2.1.23. Lidhur me pretendimin se *"6.Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera ekuivalente, me permiresimnga softueri) >= 35 MHU. Per te njejta arsye te permendur me siper kerkojme qe kjo*

*kerkese te hiqet fare dhe te ngelet vetem kapaciteti ngrohes te jete 5 MHU pa permiresim nga softëëare. AK ka bere ndryshim por perseri ka lene nje kerkese qe perjashto firmen tone nga pjesmarrja ne gare. Kerkojme qe kjo kerkese te hiqet nga specifikimet teknike.",* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: autoriteti kontraktor pas ankimit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor ka gjykuar se, specifikimi teknik i vendosur nga AK do te ndryshohet, duke publikuar shtojcën përkatëse si më poshte:
Ishte:
Kapaciteti ngrohës i Anodes (vlera ekuivalente, me përmirësim nga softueri), MHU≥ 35 MHU
Bëhet:
Kapaciteti ngrohës i Anodes (vlera ekuivalente, me përmirësim nga softueri), MHU≥ 30 MHU
III.2.1.24. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, dhe 1.1. dhe 6, të Ligjit nr.9643, datët.20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku është parashikuar shprehimisht se: "Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin." "Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik." Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: "Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor."
Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky është një pretendim i ri, i ngritur rishtazi në KPP, sqarojmë se nuk do të merret në shqyrtim pasi nuk ka respektuar rrugën e ezaurimit të ankimimit në autoritetin kontraktor në kuptim të nenit 63 të LPP. Ndërkohë që operatori ekonomik ankimues, ka patur në dispozicion momentin procedurial në lidhje me kundërshtimin e modifikimit të kryer nga autoriteti kontraktor, në respekt të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimet nuk merren në shqyrtim.

III.2.1.25. Lidhur me pretendimin se *"7. Fuqia,këë (vlera ekuivalente, me permiresim nga softueri) ≥ 48 kw. Ne kerkesat teknike shohim kerkesa te cuditshme si psh. fuqia maksimale e kerkuar e gjeneratorit pa permiresim nga softëëare-i eshte >= se vlera "X" dhe fuqia maksimale e kerkuar e gjeneartorit me permiresim nga softi eshte >= se vlera "Y".",* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo argumenta të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* dhe të përgjithshme në lidhje me kërkesat e mësipërme. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht

ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimimit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 20, *“Forma dhe përmbajtja e ankesës”,* pika 3, gërma “a”

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”*

III.2.1.26. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 63 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 ”Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se: ”Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendojsen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson se, fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhues vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht sine qua non se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së proves referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “ në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion. Në rastin konkret, pesha specifike e barrës për të provuar hartimin e dokumentave të tenderit në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi është e plotë dhe qëndron mbi pretenduesin, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se cilat kritere/specifikime teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë të gabuara apo diskriminuese.

Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të dokumentave të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i

Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.
Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

III.2.1.27. Lidhur me pretendimin se *"8.Fuqia,këë (vlera ekuivalente, me permiresimnga softueri) ≥ 250 kw. AK ka bere nje ndryshim duke e bere: Fuqia,këë (vlera ekuivalente, me permiresim nga softueri) ≥ 120 këë. Sic ju qartesuam edhe me larte, fuqia maximale e gjeneratorit nuk mund te rritet me ane te nje licence softi. Parametrat teknik te gjeneratorit jane te percaktuar si psh këë dhe mA jane te percaktuar fiks. Kerkojme qe kjo kerkese te hiqet.",* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: Autoriteti kontraktor ka marrë në konsideratë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues duke bërë njëherazi edhe ndryshimet përkatëse në speficikimet teknike të cilat janë të publikuara në shtojcë. Konkretisht citoj:

***Ishte:***

*Fuqia, kË (vlera ekuivalente, me përmirësim nga softueri) ≥ 250 kË,*

***Bëhet:***

*Fuqia, kË (vlera ekuivalente, me përmirësim nga softueri) ≥ 120 kË,*

Sa më sipër në lidhje në zbatim të këtij vendimi autoriteti kontraktor ka pasqyruar njëherazi edhe ndryshimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit për aq sa është pranuar prej autoritetit kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, dhe 1.1. dhe 6, të Ligjit nr.9643, datët.20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku është parashikuar shprehimisht se: "Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin." "Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik." Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: "Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor."
Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky është një pretendim i ri, i ngritur rishtazi në KPP, sqarojmë se nuk do të merret në shqyrtim pasi nuk ka respektuar rrugën e ezaurimit të ankimimit në autoritetin kontraktor në kuptim të nenit 63 të LPP. Ndërkohë që operatori ekonomik ankimues, ka patur në dispozicion momentin procedurial në lidhje me kundërshtimin e modifikimit të kryer nga autoriteti kontraktor, në respekt të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Si rrjedhim ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim

III.2.1.28. Në lidhje me pjesën e dytë të kërkimit se: *"Parametrat teknik te gjeneratorit jane te percaktuar si psh këë dhe mA jane te percaktuar fiks. Kerkojme qe kjo kerkese te hiqet"* KPP gjykon se kjo kërkesë është e pabazuar pasi operatori ekonomik nuk parashtron fakte apo argumenta të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* dhe të përgjithshme në lidhje me kërkesat e mësipërme.

Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimimit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe "elementet e domosdoshëm të ankesës" sipas përcaktimeve të nenit 20, *"Forma dhe përmbajtja e ankesës",* pika 3, gërma "a"

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;"*

Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se

Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo argumenta të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* dhe të përgjithshme në lidhje me kërkesat e mësipërme. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimimit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe "elementet e domosdoshëm të ankesës" sipas përcaktimeve të nenit 20, *"Forma dhe përmbajtja e ankesës",* pika 3, gërma "a"

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;"*

III.2.1.29. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 63 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar ku parashikohet se: "Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin." Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendojsen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson se, fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhues vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht sine qua non se

specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së proves referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në të cilin parashikohet se: " në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion. Në rastin konkret, pesha specifike e barrës për të provuar hartimin e dokumentave të tenderit në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi është e plotë dhe qëndron mbi pretenduesin, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se cilat kritere/specifikime teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë të gabuara apo diskriminuese.

Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të dokumentave të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

III.2.1.30. Lidhur me pretendimin *"9. Gjatesia e shtratit cm ≥ 220cm. AK nuk e ka trajtuar fare kete kerkese. Gjykojme qe eshte teresisht e panevojshme te percaktohet gjatesia e shtratit mbi te gjitha ne te tilla nivele duke qene se nuk ndikon aspak ne cilesine e ekzaminimit te pacientit. Kerkojme qe ky specifikim te hiqet.",* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: Autoriteti kontraktor ka marrë në konsideratë ankesën e operatorit ekonomik ankimues duke bërë njëherazi edhe ndryshimet përkatëse në speficikimet teknike të cilat janë të publikuara në shtojcë. Konkretisht citoj:

**Ishte:**
Gjatësia e shtratit, ≥ 220 cm
**Bëhet:**
***Hiqet Specifikimi: Gjatësia e shtratit, ≥ 220 cm***
Përsa më sipër pretendimet e ankimuesit për këtë pikë nuk do të merren në shqyrtim. r

III.2.1.31. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “BNT Electronics” sh.p.k., me arsyetimin se *“10. Kapaciteti i peshes se shtratit ≥225 kg. AK ka modifikuar kete kriter por jo duke e bere ate gjitheprfshires. Per te pasur nje proces sa me te hapur kerkojme qe kapaciteti i peshes se shtratit te jete ne nje kufi mete pranueshem, pasi kapaciteti i kerkuar i pergjigjet nje popullsie obeze. Kerkojme qe ky specifikim te ndryshohet dhe te behet >= 200 kg. ”,* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: autoriteti kontraktor ka pranuar ankesen e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe ka bere modifikimet perkatese ne specifikimet teknike duke publikuar shtojcën përkatëse si më poshte:

***Ishte:***

*Kapaciteti i peshës së shtratit, kg ≥ 225 kg*

***Bëhet:***

*Kapaciteti i peshës së shtratit, kg ≥ 220 kg*

III.2.1.32. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, dhe 1.1. dhe 6, të Ligjit nr.9643, datët.20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku është parashikuar shprehimisht se: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.” Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky është një pretendim i ri, i ngritur rishtazi në KPP, sqarojmë se nuk do të merret në shqyrtim pasi nuk ka respektuar rrugën e ezaurimit të ankimimit në autoritetin kontraktor në kuptim të nenit 63 të LPP. Ndërkohë që operatori ekonomik ankimues, ka patur në dispozicion momentin procedurial në lidhje me kundërshtimin e modifikimit të kryer nga autoriteti kontraktor, në respekt të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimet nuk merren në shqyrtim.

III.2.1.33. Lidhur me pretendimin se *“11. Rezolucioni Maksimal i Kontrastit(MTF) ne 4% ≥18 Ip/cm. Vlerat e kerkuara per rezulucionin maksimal hapsinore jane vlera per prodhues specifik. Cdo prodhues*

*ka teknollogjine vet dhe keto vlera kane te bejne me parametrat e skanimit. Vendosja e ketyre paramatrave fiks sipas nje prodhuesi te caktuar behet vecse per eliminim e konkurences. Kerkojme qe kjo kerkese te hiqet nga specifikimet teknike ose te lejohen edhe rezolucione te prodhues te tjere. Vlerat e kerkuara per rezulucionin maksimal hapsinore jane vlera teorike per prodhues specifik dhe nuk jane vlera te matshme. Kerkojme qe kjo kerkese te hiqet nga specifikimet teknike. Vlerat e kerkuara per rezulucionin maksimal hapsinore jane vlera teorike per prodhues specifik dhe nuk ja ne vlera te matshme. Kerkojme qe kjo kerkese te hiqet ose te vendoset sipas Standartit Europian."* Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, autoriteti kontraktor organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike
të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. KPP konstaton se auroriteti kontraktor nuk ka argumentuar rëndësinë e këtyre parametrave për funksionalitetin e pajisjes në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masat për të modifikuar specifikimin e mësipërm. Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2.1.34. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "BNT Electronics" sh.p.k., me arsyetimin se *"12. Njesia e perpunimit qendror CPU 2 x Intel Xeon (ose ekuivalent), RAM ≥32GB, HDD ≥ lTB, 2 x LCD Color Monitors 19 inch, USB, Gbit Ethernet. Per te njejtin arsyetim si te Njesia Qendrore e skanerit me 16 slice kerkojme qe keto specifikime te hiqen.",*
Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: autoriteti kontraktor pas ankimit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor ka gjykuar se, specifikimi teknik i vendosur nga AK do te ndryshohet, duke publikuar shtojcën përkatëse si më poshte

**<u>Ishte:</u>**

Njësia e përpunimit qendror CPU 2 x Intel Xeon (ose më mirë), RAM ≥16GB, HDD≥1TB, 2 x LCD Color Monitors 19inch, Kartë grafike profesionale ≥ 2GB, USB, Ethernet

**<u>Bëhet:</u>**

Njësia e përpunimit qendror CPU 2 x Intel Xeon (ose ekuivalent), RAM ≥16GB, HDD≥1TB, 1 ose 2 x LCD Color Monitors 19inch, Kartë grafike profesionale ≥ 2GB, USB, Ethernet

Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, dhe 1.1. dhe 6, të Ligjit nr.9643, datët.20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku është parashikuar shprehimisht se: "Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të

dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.” Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”
Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky është një pretendim i ri, i ngritur rishtazi në KPP, sqarojmë se nuk do të merret në shqyrtim pasi nuk ka respektuar rrugën e ezaurimit të ankimimit në autoritetin kontraktor në kuptim të nenit 63 të LPP. Ndërkohë që operatori ekonomik ankimues, ka patur në dispozicion momentin procedurial në lidhje me kundërshtimin e modifikimit të kryer nga autoriteti kontraktor, në respekt të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimet nuk merren në shqyrtim.

III.2.1.35. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “BNT Electronics” sh.p.k., me arsyetimin se *“13.Shpejtesia e rindertimit te imazheve me matrice 512x512 ≥ 50 imazhe /sec. AK nuk e ka ndryshuar. Kerkojme qe ky specifikim te rishikohet dhe te vendoset nje vlere me e ulet duke qene se nuk ka ndikim te madh ne ëëorkfloëë. Kerkojme qe kjo kerkese te behet ne te pakten 40 imazhe/s.”,*

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kjo kërkesë është e pabazuar pasi operatori ekonomik nuk parashtron fakte apo argumenta të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* dhe të përgjithshme në lidhje me kërkesat e mësipërme.
Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimimit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 20, *“Forma dhe përmbajtja e ankesës”,* pika 3, gërma “a”

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”*

Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se
Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se: operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo argumenta të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* dhe të përgjithshme në lidhje me kërkesat e mësipërme. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018

"*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimimit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe "elementet e domosdoshëm të ankesës" sipas përcaktimeve të nenit 20, *"Forma dhe përmbajtja e ankesës",* pika 3, gërma "a"

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;"*

III.2.1.36. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 63 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar ku parashikohet se: "Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin." Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendojsen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson se, fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhues vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht sine qua non se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së proves referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në të cilin parashikohet se: " në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion. Në rastin konkret, pesha specifike e barrës për të provuar hartimin e dokumentave të tenderit në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi është e plotë dhe qëndron mbi pretenduesin, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se cilat kritere/specifikime teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë të gabuara apo diskriminuese.

Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të dokumentave të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili

thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.
Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

III.2.1.37. Lidhur me pretendimin se *"Gjithashtu, ne kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 6 eshte kerkuar Operatori ekonomik duhet te paraqese miratimin FDA per pajisjet mjekesore dhe pjeset perberëse te tyre, origjinale ose fotokopje te perkthyera dhe te noterizuara te vlefshme ne momentin e hapjes dhe dorezimit te ofertave. Po ashtu eshte referuar si kerkese edhe ne specifikimet teknike te pajisjes. AK ka ndrsyhuar kete kriter duke lejuar paraqitjen e CE ose FDA por perseri duke favorizuar nje operator te paracaktuar. Eshte krejtesisht e pavend dhe e tepert si dhe diskriminuese/perjashtuese kjo kerkese duke ditur qe ky standart eshte i detyrueshrne vetem per produkte qe fumizohen ne territorin e ShBA-ve. ne rastin e furnizimit te pajisjeve jashte SHBA, duhet te kerkohen plotesimi i standarteve te kerkuara Evropiane.*
*Gjithashtu referuar ligjit 89/2014 ndryshuar me ligjin 21/2020 per pajisjet mjekesore nuk citohet asnje kerkese persa i perket certifikimit FDA per pajisjet qe lejohet te importohen dhe regjistrohen ne territorin e Shqiperise. Persa me siper kerkojme te hiqet kjo kerkese nga kriteret e kualifikimit, t kerkohet vetem CE sipas standartit evropian dhe mos te lejohet paraqitja e FDA i cili eshte nje standart qe perdoret vetem ne SHBA.",* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1.38. Në shtojcën 9 të modifikuar të dokumentave standarte të tenderit "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" pika 2.3.6 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

*Ishte:*
*Pika 2.3.6: Operatori ekonomik duhet të paraqesë miratimin FDA për pajisjen mjekësore dhe pjesët përbërëse të saj, origjinale ose fotokopje të përkthyera dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave*
Bëhet:*Pika 2.3.6: Operatori ekonomik duhet të paraqesë miratimin FDA ose CE për pajisjen mjekësore dhe pjesët përbërëse të saj, origjinale ose fotokopje të përkthyera dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave*

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, autoriteti kontraktor ka pranuar ankesen e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe ka bërë modifikimet përkatëse në kriterin e veçantë të kualifikimit duke publikuar shtojcën përkatëse si më sipër.

Sa më sipër pretendimet nuk merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave* "*Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Health &Light” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Proccedurë e Hapur”, me nr. REF-65892-07-18-2020, me objekt “F.V Pajisje mjekësore –CT Scanner”, me fond limit 144.112.500 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k.për procedurën e mësipërme prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimues “Health &Light” sh.p.k. dhe “BNT Electronics” sh.p.k..
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 883Protokolli,**
**Datë 05.08.2020**

**Nr. 884 Protokolli,**
**Datë 05.08.2020**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| Nënkryetar | Anëtar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|---|
| Enkeleda Bega | Vilma Zhupaj | Lindita Skeja | Merita Zeqaj |

**Kryetar**
**Jonaid Myzyri**